

INTERVISTË ME XHAFER ISMAILIN

Prishtinë | Data: 23 shtator, 2024

Kohëzgjatja: 119 minuta

Të pranishëm:

- Xhafer Ismaili (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Xhafer, a mundeni me u prezantu, me na tregu datën e lindjes, vendin, diçka për familjen?

Xhafer Ismaili: Po. Jam Xhafer Ismaili, baba emrin e ka pasë Enver nana Mehdije. Kam lind në Kopiliç të Epërme në vitin 1949 me 7 shtator. Aty e kam kry shkollën fillore. Baba jem ka qenë bashkëluftëtar i Shaban Polluzhës. Kam qenë edhe nip i Zukë Xanit, babës të [Vehbisë](#) që ka qenë edhe ma ngusht i lidhur me Shabanin ose njeri i parë i Shaban Polluzhës. Kshtuqë familja jonë ka qenë gjithmonë shënjestër nga UDB-ja gjithmonë, gjë që m'ka përcjellë edhe mua.

Fëmijërinë nuk e kam t'mirë. Sepse mua më vdiq ni vlla 15 vjeçar dhe nana ime e çante shumë e vajtonte shumë. M'dukej se secilen ditë e kishim nga ni vdekje sepse ikte te varri i tij, vajtonte derisa shkojsha unë vajtojsha. Kshtuqë ata u përpoqen prindt e mi mu me m'ba ma t'madh sesa isha. U përpoqën unë me ua zëvendësue vllaun që m'kishte vdekë, Zymerin. Ashtu edhe banën. Më martuan në moshë shumë të re, isha shumë i ri. Veçsa fillova shkollën e mesme u dashtë m'u martu dhe me marrë obligime shumë t'mdhaja.

Anita Susuri: A keni qenë shumë fmi?

Xhafer Ismaili: Jo, kemi qenë dy vllazën e ni motër përveç atij vllaut që na ka vdekë. Nanës i kanë vdekë shumë fmi t'vegjëë, kanë vdekë shumë fmi përpara. Pastaj, kryva shkollën e mesme normale. Aty isha student, nxanës mesatar, nuk isha shumë i dallun. Megjithatë në disa landë isha i dallun, sidomos në letërsi. Fillova me shkrujtë, shkruja poezi. Shkruaja diçka që ishte në kundërshtim me pushtetin e atëhershëm.

Bile ndoshta nuk e teproj me ju tregu ni rast. Kemi pasë orë letrate që e majshim nëpër t'gjitha qytetet e mdha. Niherë me ni rast ka qenë nga grupi letrat i qytetit ni Jakup Ceraja. Jakup Ceraja ka qenë poet shumë i mirë, i ndjerë tash. Ai na përcillte neve. Unë e kisha ni vjershë për Skënderbeun. Ishte shumë e dhimbshme ajo vjershë dhe ishte shumë, u deshke me pasë shumë guxim për ta recitu atë vjershë sepse ishte koha e Rankoviçit, ishte viti '86, 87, në fakt '67, '68.

M'kujtohet mu në Pejë m'u prish ni kpuçë e nxana në ato kshtu dhe ajo pjesa e poshtme i binte. Jakupi e lunte Rizahin. Atëherë u thirrke Rizah Hadja se s'guxojke m'u thirrë Rizah Grajçevci puna e Fazli Grajçevcit. E lunte që ai ishte si arkatar, "M'jep naj pare me ndreqë kpuçën", po nuk m'i dha. Na kishim me shku edhe në Gjakovë, në Prizren edhe m'u kthy në normalen e Prishtinës kha. Kur u kthym, Jakupi u anku te drejtori, ishte drejtor i ndjeri Ahmet Maloku. Që prej tina ma së pari e kom njoftë Shtjefën Gjeçovi, s'e kom njoftë përpara kurrë.

I thotë, "Xhaferi e ka shti shkaun me rre shuplakë për Skënderbeun me atë vjershen, me ato citate që recitonte". Ai ma jep mu ni letër, nuk disha pse ma dha drejtori atë letër. Tha, "Shko me ni librari". Ai m'i dha dhetë mijë dinar janë kanë atëherë. Ju thojshin ni kali i kuq. Unë ia ktheva ato paret. "Ja kto t'i kom dhanë me ble kpuçë", drejtori. I bleva ni parë kpuçë edhe më teprun edhe 30, si tash me thanë 30 euro. "Jo jo", tha, "ato merri". Me ato jetojshe gjatë.

Më kujtohet kj osi ni moment shumë i randë që ka qenë n'ato kushte tona t'rana ekonomike. M'u dok që m'dha kushedi se sa. Pastaj pasi e kryjta shkollën normale sigurisht se isha, më kishin shenjestër me ato poezi që kisha shkrujtë unë. E kishim Fahredin Gungën që ishte ni nxitës i madh për poezi. E ndërpreva poezitë unë, ndërpreva se erdh profesor tjetër që s'po du me ia përmend emrin që më fyente pse po shkruaj. E ndërpreva. Kur dola n'punë nuk deshtën me më marrë aty ku dojsja unë. Më thojshin me shku me ndonjë fshat tjetër, jo n'atë bashkësinë lokale ku e kisha kry shkollën. Me këmbëngulje unë mbeta aty.

U bonën demonstratat e '68-tes. Na nxanën si mësues demonstratat e '68-tes. Erdhën me ba vlerësimin e demonstratave. Disa shokë që i kisha pasë msus ma përpara thanë, "A don me çu gishtin me dënu demonstratat?" Thashë, "Po t'hyjmë niherë në mbledhje, t'shohin, ndoshta nuk na detyrojnë nashta me ngrit dorën". Mirëpo bash qata që m'kishin thanë kur erdh puna me ngrit dorën ikën dolën jashtë, unë nuk e ngrita dorën. Ata gjaja se po e dojnë babën tim, hatri i mixhës Enver dojna m'i shti edhe niherë se e çon djali i mixhës Enver dorën.

Ata hinën ndërkohë ata që kishin thanë s'kena me ngrit dorën. Dhe e ngritën dorën (qeshë dhe ngrit dorën lart). Nuk e ngrita dorën. Ajo që është interesant, këshilli i komunistëve aty që ish, s'di qysh e qujshin atë se s'më ka interesu kurrë komunizmi, organizohen dhe vijnë n'odë te baba me m'shti mu me çu gishtin. Frikësohesha se mos po m'thotë baba çu gishtin. Babës tem për ata ia kom rregullu vorrin aq mirë se qëndroj shumë mirë.

I tha ai që, "Ky sonte", tha, "mixha Enver", tha, "nuk kemi ardhë për qef, deri na ka pru", tha, "se djali yt sot ishim ma shumë se 60 vet që e çun gishtin i vetmi djali yt nuk e çoj gishtin. Ti e din mixha Enver, atë djalin tjetër e ki shumë t'lazdrun, për vllaun, nip i Zukë Xanit. Djali yt le te çon gishtin përndryshe dreqi e merr. Baba që e pinte cigaren me ni kshtu si cigarlluk, i ra asaj take tukës së llastres disa herë ting, ting, ting {onomotope}. Sikur me dashtë me ua tërhjekë vrejtjen t'gjithëve. Tha, "Qyre", atina s'po ia përmendi emrin se s'osht' mirë. Tha, "Xhaferaxh", Xhaferaxh m'tha mue. Se kur... "Ka bo keq, kur e

kanë çu 60 vet pse mos me çu edhe ky. Sa për ktu me ma gri sikur duhanin gisht s'ka me çu n'odë teme". U prish puna aty.

Ata e kishin pasë vetëm sa me m'korit. Unë aty duke zbrit shkallëve njëni ma vuri dorën m'tha (kap dorën e vet me dorë), tha, "Lumi ti çfarë babe paske", tha, "se kta janë ardhë me t'marrë". Kishin ardhë, maricë i thojshin atij kerrit që e marrshin. Kishin ardhë me më marrë. Ajo që m'ka mbetë kshtu brengë që nuk m'lanë afat m'i thanë babës faleminderitë. Ma ulën krytë edhe m'ulën aty. Mos me çu gjatë...

Anita Susuri: T'morën me veti a?

Xhafer Ismaili: Po po më morën. Po axha tani me disa tjerë ma kanë ba hallin që nuk m'kanë lanë me nejt shumë nëpër burgje edhe me hjekë keq. Ata nuk m'kanë lanë. Pse? Çfarë? Na e kemi pasë nifar' Abazi, ka qenë... ai s'ka pasë... ai shpëtonte shumë njerëz ka shpëtu, jo vetëm mu. Mirëpo ajo dosja më mbetë mue.

Anita Susuri: A ju kanë... veç në mbajtje ju kanë mbajte a po? A ju kanë torturu?

Xhafer Ismaili: E torturimi tash të tregoj, fillojnë ma vonë. Mbas '81-shes torturimet. Shpëtova unë po ajo dosja ish mbetë ajo. Tito kur vinte n'vizitë në Kosovë mu më marrshin gjoja se në biseda informative. Unë e disha pse po më marrin po kush isha unë me i ba Titës sen? Ni grusht njeri. Po qashtu ata e kishin.

Anita Susuri: Po zoti Xhafer, po du edhe diçka me ju pytë para se t'kalojmë te ajo pjesa, se po e përmendni babën edhe... a ju kujtohet diçka që ju ka tregu për kto luftimet që janë bo me Shaban Polluzhën?

Xhafer Ismaili: Po si nuk m'kujtohen...

Anita Susuri: Se s'ka edhe shumë shumë hulumtime prej njerëzve.

Xhafer Ismaili: Kur vinte një fqinj i imi me nejt me babën, i thoshte, "Ti more Enver je avdall". Kjo puna avdall ish nuk je n'rregull, budallë. Thojke, "Qysh deshte me na vra në mes Novi Pazar". Ky i thoshte, "Po valla kom dashtë me ju vra". Sepse kta kanë qenë në Novi Pazar kanë luftu, kta të Shaban Polluzhës. Tash kanë hy me ni grup ku disa të Bosnës, disa gra boshnjake ju kanë kthy bukë edhe ju kanë kthy bukë për shpejt. I kanë thanë ni lloj heje kaçamak. Tha, "Për me na ba se s'kishim hangër me ditë e me javë bukë na bonën ma shpejt", tha, "kta fillun m'i ngacmue edhe baba ua ka kthy pushkën ka thanë 't'gjithve ju vras. Si e prekni njo me dorë ktu unë ju vras'".

Kjo ka qenë e vërtetë, për ata ai thoshte kshtu. Atë ngjarje ka pasë aty për shembull ka pasë edhe konfilte në mes veti luftëtarëve tanë. Për shembull për ndarje të fyshekëve. Ka qenë ni Zgjaha Kosova

tregojke baba, “Zgjaha edhe Shabani janë ngatërru. ‘Ti luftëtarëve tu ju ndajte ma shumë monicion se luftëtarëve t’mi’”. E qiky daja jem ju ka hy ndërmjet thotë, “Mosni, na nuk kemi ardhë kha me luftu mes veti, kemi tjetër armik”. Ka pasë aso ngjarje interesante. Mandej tregonte baba se si ia kanë thirrë tallkinin. Tallkin nuk di... tallkini është ni lutje kur vdes njeriu, masi t’vdes. O’ i biri i filanit, filanit t’çoftë zoti në...

Anita Susuri: A si me ça.

Xhafer Ismaili: Po. Tash ju mund të vdisni në fronte e nuk ka hoxhë që ua thurret tallkinin, që ua bon këtë lutje prandaj për së gjalli po ua boj. Merre me mend tash Shabani sa psikolog ka qenë, i ka thanë, “Mjaft”, atij hoxhës, “kurrë ma kshtu”. Sepse e ka pa që moralisht po ndikon shumë keq te luftëtarët e tij. Kjo është shumë interesant. E ngjarje plot. Babën tem tri herë e kanë qit me pushkatu, tri herë m’qitën edhe mu n’këtë luftë dhe shpëtova, edhe baba shpëtoj. Domethanë ato që i kishte përjetu baba i përjetova edhe unë këtë luftë.

Domethanë ishin shumë... unë ktu kam qenë në Prishtinë, ktu te, që nuk e harroj kurrë dhe jam t’u shkru libër për të, për familjen e Azem Lajçit, baba i tij Pajazit Lajçi. Ktu ai e ka mbajtur 20 familje të Drenicës, Pajazit Lajçi. Po ajo është ni histori n’veti. Po ajo që po du m’u kthy tash se pas ‘81-tes kta i kishin ato shënimet, i kishin ato dosjet që i mbajshin dhe fillun ato malltretimet tjera. Kshtuqë m’u deshtë mue n’vitin ‘70-’71 me lshu punën. I çojshin të gjithë me rrogë, të gjithë jo, po ata njerëzit e vet i çojshin me rroga. Neve s’na dhashin as kredit, as bursë as kurgjo. Me shpenzime tonat studimet i kom kry, shpenzime personale, të babës.

Pas krymjes të fakultetit, ne jse ni vit kom punu në Lipjan edhe kom studiu edhe kom punu isha shumë i ri. Nxanësit e mi ende nuk ishin rru, unë hala s’i kisha ra brisk ftyrës ata ishin... aty mbarova për ni vit mandej shkova ushtar dhe u ktheva. Kur u ktheva fillova punën në gjimnaz...

Anita Susuri: Veç po më intereson, ju edhe keni ardhë në Prishtinë në Shkollë Normale?

Xhafer Ismaili: Shkolla Normale ka qenë në Mitrovicë.

Anita Susuri: Në Mitrovicë.

Xhafer Ismaili: Shkolla pesë vjeçare ka qenë në Mitrovicë.

Anita Susuri: A ka qenë e vështirë për juve me udhëtu? A keni udhëtu a?

Xhafer Ismaili: Ajo ka qenë peripeti n’veti, peripeti n’veti. M’i thanë diku që kam shku prej Kopiliçit të Epërm n’kam edhe e kom nxan orën e edukatës fizike. Se me thanë hajt edukatë fizike mos t’e nxa, po prej Kopiliçit të Epërm në Mitrovicë i ka 15 kilometra deri në Skenderaj, 22 kilometra i ka prej

Mitrovicës. Po na kemi gjetë rrugë alternative që i kanë shkurtu kapak rrugët domethanë. Veç dikund 30-35 kilometra kanë qenë. Edhe e kom nxan orën e edukatës fizike. Nashta keni ni për Lah Nimanin ka qenë trajner i boksit, ai na ka dhanë edukatë fizike n'atë kohë.

Kur na qitke n'orë se kemi vrapu kapak nëpër oborr mandej me bo ushtrime m'sheh mu të sarrakuqun edhe të ndjersitun. M'thotë, "Ti?" I thom, "Unë kom ardhë sot...", "E paske mbaru ti orën", (qeshë), "pusho". Po kanë qenë peripeti shumë t'mdhaja kto. Dikush nuk ka qef me përmend se ka qef me thanë kom qenë i pasur e kom qenë kshtu. Jo. Baba jem ka qenë i pasur, ka qenë i pasur. Po ajo kohë ka qenë kur unë s'kam qenë. Kur jam ba une baba s'ka pasë naj pasuni me thanë, kemi hjekë keq t'gjithë. Kemi jetu në Shkollë Normale pesë vjeç ka zgjatë ajo.

Anita Susuri: E shkolla a ka qenë e perzine? A keni pasë edhe klasë të serbëve?

Xhafer Ismaili: Kur e kemi fillu shkollën klasën e parë edhe të dytë gjimnaz, normale, kemi pasë ma shumë se gjysëm e landve serbisht a na nuk dishim serbisht. Ishte shumë vështirë. Bile bile gjuha angleze që mos me mësu unë kurrë gjuhën angleze edhe sot mos me ditë, është pasojë e asaj kohe. Se ajo msusja që na jepke gjuhë angleze ishte serbe. Ajo na përkthejke prej anglishtes në serbisht, na serbishten s'e dishim edhe ma hiç s'e dishim. Kshtuqë metëm edhe fitum nifar' averzioni ndaj gjuhëve t'huaja se kshtu ka pasë vështirësi shumë.

Te shkencat natyrore nuk diktohej shumë ajo se ishin ma praktike ma kshtu kishte, kishte ma shumë punë me formula edhe skema të ndryshme. A te shkencat shoqërore ndikonte shumë te ne, kemi pasë shumë probleme. Prej vitit të tretë na ndajten, shqiptarët vet paralele, serbët vet paralele jo ma bashkë serb e shqiptar, prej vitit të tretë në normale.

Anita Susuri: Po m'intereson edhe Mitrovica n'atë kohë, se di sa keni pasë kohë për shembull ju m'u marrë me ndonjë ngjarje kulturore? Tregut që keni shkru poezi, a ka pasë...

Xhafer Ismaili: Ndoshta...

Anita Susuri: Ndonjë shikim t'filmave ose...

Xhafer Ismaili: Ndoshta, ndoshta ju do t'thoni se po e hiporbolizon gjërat profesori por i thom drejt. Ma shumë ka pasë gjallëri e kulturë, e art, e film, e teatër në Mitrovicë sesa në Prishtinë n'atë kohë. E kqyre tash Mitrovica çka u ba, me vajtu për ta. Mitrovica... se ishte qytet industrial, aty boheshin investime t'mdha, aty zhvillohej kultura, aty zhvillohej arti, aty zhvillohej muzika, aty kishte poet, aty ishte Latif Berisha, aty ishte Fredin Gungna, aty ishte Jakup Ceraja, aty ishin plot njerëz e njerëz që ipshin e kontribonin shumë për atë kohë.

Anita Susuri: A mundeni me na tregu nëse keni kujtesë diçka prej ktyne ngjarjeve që keni shku? Ndonjë film? A keni pasë ndonjë organizim me shoqëri ose me shkollë?

Xhafer Ismaili: Po, organizime kemi pasë po kemi qenë t’kufizun. Kemi qenë t’kufizun. Unë harrova me ju thanë, jo që harrova po prej asaj frike që po bohem i terpërt...

Anita Susuri: Jo, jo ju m’tregoni sa të doni.

Xhafer Ismaili: Ne u frymëzum në Shkollën Normale dhe atë frymëzim tonin e shprehnim n’punë me nxanësit tonë. Bile kur u vrajtën dy vllazën të Qirezit, unë u mërzita shumë, sepse thashë, “Ne i kemi pajisë me municion”, municion figurativisht me emocione qysh duhet me dashtë atdheun kta i morën pushkën dhe dolën e vdiqën. Domethanë na e kishim, e kishim frymëzu. Kur citonte Faredin Gunga nuk kishe qare pa derdh lot, sidomos për Migjenin kur na spjegonte për Ndre Mjedën, për Filip Shirokën. E edhe ne fillim me u frymëzu prej tyne.

Ni ngjarje që m’kujtohet ishte pak para se me lëshue punën unë në Truiçec. Se aty më morën brina që thojnë kta, nuk më dojshin. Dojsha unë me vazhdu fakultetin. Ishin dy-tre ditë... ishte ajo koha kur nuk guxonim me shpreh emocione të tona po megjithatë ato shpërthenin vetëvetiu. Ai drejtori që s’më donte mu fare s’më donte, pse e recitova unë atë vjershen Skënderbeu edhe u deshte me gjeste, me ni za, “Skënderbeu ti s’ke vdekë ke tërë gjakun ndër shqiptarët. Për ty s’ka vorr ti jeton me ne”. Ky i thotë atyne, thotë, “Ju kom thanë more burrë që ky është i çmendur pse s’i bërtet? Ky është i çmendur”.

Domethanë e krijonte edhe n’popull e krijonte ni imazh t’keq për patriotat. E krijonte ni imazh t’keq për njerëzit e ditur, e krijonte ni imazh t’keq për njerëzit e guximshëm, e krijonte ni imazh t’keq për ata që i rezistojshin atij pushteti të atëhershëm. Se erdha te do momente kur unë isha ose nuk isha hiç që kanë ardhë e kanë rrethu shpinë tonë për babën e Vehbisë, për Zukën.

Anita Susuri: Ku ka qenë kjo?

Xhafer Ismaili: Zuka... ‘45-’46-’47. Se Zuka i kishte dy motra aty. Axha edhe baba i kishin gratë motra, i kishin motrat e Zukës. Ata thojshin sigurisht Zuka rrin aty. Vishin gati shumë shpesh, nuk kalonte javë pa e rrethu shpinë tonë. Ni moment e rrethojnë gjithë mysafirët i qesin përjashta edhe anëtarët e familjes që në qoftëse ai diçka kërset me i pushkatu kta të gjithë. Hip njani në tavan atje me hulumtu atje, nëpër katune që ka pasë aso fshisa e rrakshtaja. I shymet ai filaqi atij shkaut. Thotë, “Zuk o dreqo, mos ma shkym gazin”. “Zuk o dreqo”. Nana i thotë, “Dreqi ta hant kryt se ti p’e din që s’o Zuka kërkund ktu se s’kishe guxu as n’katund me hy”.

I thotë atij axhës që e ka nanë... “E pase nanën shumë t’vështirë”. Po po du me bo nifar’ krahasimi tash unë ktu. Baba i ka ofendu, shumë i ka ofendu. Axha ju ka thanë, “Mos e merrni kta po më merrni mu. Se ky i ka letrat që s’o n’regull”. Axha ka sakrifiku shumë për të tjerët. E kanë marrë, e kanë çu në

Skenderaj dhe i kanë thanë, “Kur t’pysin atje trego qoftëse e kemi malltretu dikond, tregona. Në qoftëse t’thojnë a kanë kontrollu? Thuju valla gjilpanë me kanë pa e gjetë s’e kishin lanë”.

Domethanë po e boj këtë krahasim. Atëherë nuk kanë qenë aq të ashpër sa kanë qenë në këtë luftën që u bo tash. Domethanë nuk i kanë malltretu familjen, nuk i kanë malltretu. Kanë kontrollu e kanë... a ktu si kanë ardhë kanë ra Imer Elshani me krejt familjen.

Anita Susuri: E Zuka a ka qenë si luftëtar?

Xhafer Ismaili: Zuka ka qenë luftëtar, luftëtar i madh. Luftëtar bile i pari i Shaban Polluzhës, njeri i parë. Bile kta, kta shkrujnë, kta shkijet kanë shkru serbisht. Shaban Llopuzha, Llopuzha i kanë thanë, nënçmim, s’i kanë thanë Polluzha, t’poshtër. “Naređuje, Zuka izvršuje”. Shabani urdhëron Zuka ekzekuton. Domethanë kanë pasë ata, Zuka ka qenë luftëtari ma i madh aty.

Anita Susuri: Deshta me ju pyetë edhe m’u kujtu...

Xhafer Ismaili: Baba i Vehbisë.

Anita Susuri: Për shembull a ka pasë aty t’rrethit t’juj për Tivar që i kanë marrë m’i çu qat’ kohë?

Xhafer Ismaili: T’katunit tim nuk ka pasë, t’katunit tim nuk ka pasë. Të fshatit të Vehbisë po. Bile ka qenë ajo Azem Xani ka shkrujtë edhe ni libër, Lufta e Tivarit. Ai ka qenë, i ka shpëtue atij masakre. Po të fshatit tim nuk m’ka thanë kush.

Anita Susuri: E kshu gjatë kohës së Rankoviçit që i kanë mbledhë armët a ka pasë...

Xhafer Ismaili: Gjatë kohës së Rankoviçit jo veç që kanë mbledhë armë po edhe i kanë vra njerëzit, i kanë pre, i kanë mytë, i kanë masakru. Dikush ka mujtë me shpëtu, dikush s’ka mujtë m’i shpëtu asaj. Kanë nejt njerëzit nëpër molla, kanë nejt nëpër dardha. Babës tim nuk ia kanë kërku ni armë po ia kanë kërku ni sanak armë. Ky e ka gjetë ni mik t’vetin, mik t’vetin që e kishte shpëtu përpara prej Mehmet Gradicës. Se Mehmet Gradica ka qenë mik i babës tim edhe dajë i axhës tim. Se baba edhe axha nuk kanë qenë vllazën prej nane e prej babe. Tash ia ka pasë borxh ai edhe e ka shpëtu babën prej...

Domethanë ka pasë kso peripeti shumë t’mdhaja në kohën e Rankoviçit. Vllau ka qenë shumë i njekun, Haxhia. Sa u detyru edhe mbiemrin me ndrru. Ai ka qenë jurist është qujtë Haxhi Gashi, jo Haxhi Ismaili sepse u deshtë me ndrru mbiemrin që qaq shumë ka qenë i ndjekun prej UDB-së.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Deshta me bisedu edhe pak për punën që thatë... domethanë '73-ten '74-ten fakultetin e keni përfundu, po qysh ka qenë edhe përvoja n'fakultet?

Xhafer Ismaili: Po...

Anita Susuri: Ka qenë koha kur osht' hapë universiteti...

Xhafer Ismaili: Po në '70-ten u krijua Universiteti i Prishtinës edhe aty ishte në fillim edhe n'fakultet i kishim ma shumë se gjysën e landëve serbo-kroatisht. Mirëpo tani n'fakultet veç e dishim, nuk na vinte zor, e dishim serbishten.

Anita Susuri: Tash ishit në Prishtinë?

Xhafer Ismaili: Po, në Prishtinë. E kishim në kuadër shumë të zgjedhun, në kuadër shumë t'mirë. Ishte Sali Nushi, ishte [Pajazit Nushi](#), ishte Nik Juniku, ishin Jashar Rexhepagiqi. Ai ka kontribuar shumë edhe pse ishte musliman. Ka qenë... po s'ka qenë shqiptar po ka kontribuar shumë për shqiptarët. Sepse unë ju thom t'drejtën shpesh herë thojnë për Sterjo Spasën¹, "Pse ta mësojmë Stereo Spasën se ai ka qenë maqedon?" Po ai ka qenë maqedon po përveç Ismail Kadaresë kush i ka kontribuar ma shumë letërsisë shqipe?

Bile bile ka të "Zgjimi" atje të "Pishtarët" ka në personazh shumë interesant, në Aristotle. Ai Aristotle osht' grek po osh' msus që e çan hallin e shqiptarëve. Ju thotë nxanësve shqiptar, "Pse keni faj ju që e flisni gjuhën e nanës t'juj? Pse keni faj ju që ju ka lindur nana shqiptar?". Domethanë të tjerët kanë kontribuar shumë. Edhe Jashari ka kontribuar për, sidomos për pedagogjinë nacionale shqiptare. Kanë qenë kuadra t'forta. Pajaziti osht' ma i paharrueshëm. Unë kam shkrujtë për t'gjitha veprat e tij gati, për t'gjitha librat e tij edhe ka qenë organizues i përvjetorëve të Lidhjes së Prizrenit gjithmonë. Pajazit Nushi ka qenë organizues i të gjitha organizimeve të përvjetorëve të Lidhjes së Prizrenit, se e ka njoftë atë lami.

Ishin fillimet aty, kishte vështirësi. Kishte vështirësi edhe me literaturë. Nuk kishte kush na oriento. Unë për shembull në bibliotekë isha në bibliotekë krahinore që i thojsin atëherë. Nuk ka qenë ajo biblioteka ka qenë në bibliotekë e shkatërrune, mezi i gjejshim librat. M'gjen njërin t'u e lexu Kapitalin e Marksit. M'thotë, "Ti në ekonomik je kah e studion?" "Jo, çka po t'duhet Kapitali i Marksit". Domethanë veç dojsim me gjetë diçka me lexu, dojsim me pasë libra. Pa marrë parasysh veç a osht' libër na e

¹ Sterjo Spasse (1914-1989) ishte shkrimtar, mësues dhe përkthyes shqiptar nga Prespa. Ai njihet si një nga themeluesit e prozës moderne shqiptare. Romani i tij i parë "Pse?!" (1935) konsiderohet si një nga veprat e para moderne në letërsinë shqipe, ndërsa romane të tjera të rëndësishme janë "Afërdita" (1944) dhe "Ata nuk ishin vetëm" (1962). Spasse gjithashtu përktheu autorë të huaj dhe ka dhënë kontribut në zhvillimin e arsimit në Shqipëri.

marrshim e lexonim. Tani i shoh sa libra janë shkelur nëpër tokë, nuk i lexon kush osht' mjerim, osht' mjerim me t'vërtetë.

Anita Susuri: Po kjo u kanë koha kur ka qenë ni bashkëpunim kulturor me Shqipninë. A keni vrejtë diçka? Qysh e keni përjetu?

Xhafer Ismaili: Po t'ju thom t'drejtën ishte ajo koha kur fillun profesorët e Shqipërisë me ardhë po n'katedrën e gjuhë e letërsisë. Ne t'pedagogjisë shkojshim, i lajshim ligjeratat tona shkojshim me dëgju atje, me ndëgju ligjerata nga profesorët e Shqipërisë. Ishte ajo gëzimi ma i madh kur nijshim ata t'u folë. M'kujtohet tash ni moment se kto ngjarjet që ndodhën n'vitin '81 ato kanë qenë t'frymëzuara nga ata. Se ata erdhën vitet '78, '79 erdhën dhanë koncerte. E di bash në Mitrovicë koncerti që osht' mbajtë bash te Ura e Ibrit që tash u bo si ajo ura e shejtë, po përmendet aq shumë.

Koncerti që u mbajtë aty ka qenë ni kangë, 'Dredh cigarën prej kutisë që ia qet i zoti i shpisë'. Ka qenë kangë. Bik Ndoja m'doket e këndonte. Nuk e di si e këndonte. Tash krejt çka ka pasë publiku cigare krejt që i kanë gjujtë në binë, krejt i kanë gjujtë në binë, i kanë gjujtë krejt cigare. Kanë qenë, femrat tona e hiqshin dukatin prej qafe, prej gishtave ua dhashin këngëtareve të Shqipnisë. Nifar', nifar' entuziasmi shumë i madh, nifar' vullneti shumë i madh që i paraprinte asaj që ndodhi në '81-shen, i paraprinte. Kemi qenë shumë të frymëzuar prej tyre.

Anita Susuri: Po m'intereson edhe a keni marrë pjesë ndonjëherë ktu domethanë kur janë bo vallet e kto edhe në Prishtinë? Në Teatrin Kombëtar.

Xhafer Ismaili: Na kemi qenë ktu sa ishim si studenta, kemi qenë shumë aktiv. Kemi marrë pjesë n'teatra, kemi marrë pjesë, ka qenë Shoqëria Kulturo Artistike Shota, ajo ka qenë shumë n'za. Ka qenë Esat Bicurri i ndjeri. E ka pasë formu bile ni, ni shoqatë ktu, ni grup këngëtarë folklor. Mu m'pat' angazhu m'i ra çiftelisë po ma merrke kohen. Çiftelia ma merrke kohen edhe e ndërpreva. Esati ka qenë shumë... kanë qenë t'gjalla aktivitetet shumë. Po ka qenë nifar' edhe atëherë ka qenë nifar' rivaliteti me serbët.

Korza ktu ka qenë e ndane. Ka qenë korza e shqiptarëve, korza e serbëve. Kemi qenë kshtu edhe atëherë nuk kemi pasë, nuk kemi pasë naj lidhje me ta përveç ndonjënit që ka deviju. Kshtuqë kom shumë e shumë me thanë për profesorët e mi, kam shumë me thanë për kolegët e mi. Kanë qëndru n'kohët ma të vështira. Kanë qëndru... shpesh here kanë ra n'rreziqe t'mdha. Sidomos gjatë demonstratave. Kemi qenë mirënjohës ndaj atyre që ishin aktivista, që vinin si aktivista në Skenderaj në '81-shin. Se ata mujshin me na marrë n'qafë neve t'gjithëve.

Po ju tregoj veç ni rast. Unë isha pedagog i shkollës edhe kur vijnë me folë për Jakup Krasniqin që veç e burgosën ka qenë Fazli Kajtazi aktivist. Erdh aty po ai na shpëtoj neve se na çka folëm aty me pasë qenë naj aktivist tjetër nime djalli na kish marrë. Bile mu m'tha kur dola përjashtë ma qiti dorën rreth

qafe. “Se unë”, tha, “s’kom pasë asni profesor ma t’mirë se Jakup Krasniqim”. Unë n’atë pikëpamje pedagogjike. Kurrë s’ka shku pa përgaditje, qashtu ish. Kurrë n’orë s’ka shku pa përgaditje me shkrim, përgaditje me shkrim. Kurrë n’orë s’ka hupë.

Kur dolëm jashtë ma vuri dorën rreth qafës, ai Fazlia. Tha, “Qoftëse vjen dikush tjetër mos fol kshtu. Na nuk kemi ardhë Jakupit me ia ngrit gradat po kemi ardhë me dënu, ti po e lavdon thuti ki me ardhë me ia ngrit cenat”. Po kta kanë shpëtu, kanë shpëtu. Ka pasë shqiptarë shumë t’fortë që ju kanë ndihmu njerëzve shumë. Ata që janë ndalë e kanë punu edhe që ju kanë thanë që po punojnë hala ata që kanë dashtë i kanë ndihmu shqiptarët, i kanë ndihmu t’vet. Qe kto momente shumë, shumë t’rana. Ishin kto momente që nuk harrohen.

Me ju thanë t’drejtën, nashta kur të hy atje te shkolla shtëpia, të zgjenohem ma shumë në këtë aspektin bash të punës në gjimnaz se aty na kanë ndodhë t’kqijat ma t’mdhaja. Se u deshke me përjashtu nxanësin pse u shkru te dikush tjetër inicialet KR, Kosova Republikë, na palidhje përjashto. Çka kom unë faj kush çka m’shkrun mu. Na e përjashtojshim qata ku ish gjind parolla. Na, po thom na n’atë kuptimin, unë jo, unë i mbrojsha.

Se Hashim Thaçi e pat’ ra vi ni vjershe për Titën, ka ra vi. Ajo vajza që e ka pru atë revistë aty ka qenë vajza e kryetarit të komitetit. E tregon ajo revistën. “Kush t’i ka ra vi?” “M’i ka ra filan nxanësi”. Erdhen me përjashtu Hashimin. Mu ni djalë i axhës që punon me babën e Hashimit m’thotë, unë isha t’u shku në Shkup me ba ni inxhizim të kamës, më dhimke. Thonë, “Po dojnë me përjashtu edhe me çu në burg djalin e Haxhisë”. Vllau im e kishte emrin Haxhi. Mendova t’vllaut. Thashë, “Besnikun a?” Tha, “Jo të Haxhisë Thaçi prej Buroje”. U ktheva. Ka pasë komunistat t’përbetun aty.

E kish shkru djali deklaratën e kish pranue. Atij komunistit aty i thashë, “Jo deklaratën duhesh me shkru para meje”. Disa po thojnë, “Jo ku me të marrë? Ti s’ishe ktu”, thashë, “Qe tash jom ktu”. Mirëpo Hashimi nuk vinte ma me dhanë deklaratë, e kishte ba niherë, ishte shumë kokë fortë. Unë me ni Shaban Zhyranin thojmë, “E bojmë na ni deklaratë për to”. Thojnë, “Profesor na e njohin shkrimin”, thojmë, “Jo e bojmë te daktilografi”.

Shkojmë te ka qenë ni sekretar aty edhe shkojmë. “Osht’ e vërtetë që i kom ra vi asaj poezie po nuk i kom ra n’atë kuptimin që e keni marrë ju po n’atë kuptimin si poezi, si art nuk është në nivel”. Ai bile folke pak nër’ hund thojke, “Valla as dreqi nuk din qishtu sikur ti”. U deshke me ba gjithçka për m’i shpëtue, m’i shpëtue.

Anita Susuri: Zoti Xhafer në ‘81-ten ku keni punu? A jeni kanë t’u punu, n’fakt më tregut.

Xhafer Ismaili: Po, kam qenë në Skenderaj. M’thojnë se iken të gjithë prej Prishtine, po Haxhia s’deshti me ikë, për vllaun. Unë e marrë ni kerr edhe n’atë flakë nisna për me marrë vllaun...

Anita Susuri: A student ka qenë a ka punu?

Xhafer Ismaili: Jo, jo jurist. Po ka qenë n'pension invalidor se ka pasë ni aksident n'komunikacion. Vij unë nëpër qat' flakë. Bile në Drenas ma rrokën kta demonstruesit kerrin me ma praptu. Njëni dul me ni shkop tha, "O mosni se ky osht' kerri i profesorit i patriotit. A e dini çfarë patrioti u tregu në Gjakovë?" E mbajke mend ai ni vjelje të rrushit me nxans kur kam qenë. Edhe më shpëtoj. Erdha diqysh deri te vllau. Vllau m'qortoi. "Pse erdhe?" Thashë, "Erdha me t'marrë", "Ku po don me m'çu?" Thashë, "Po du me t'çu, krejt ikën prej Prishtine me t'çu n'fshat". "Pse", tha, "Prishtina e shkijeve është a? Prishtina osht' e jona. Ktu", tha, "ka me nejt une".

Po du me ecë une, ku me ecë u mbyllen të gjitha rrugët? U mbyll çdo gja u mbyll. Trotuarët i prishën ato tanket. Po megjithatë unë dola disi edhe po du me ecë. Kur po vi te Fakulteti Filozofik, me vetur isha, po m'del përpara i ndjeri Murat Bejta. Murat Bejta kur kom qenë në normale ka qenë drejtor i gjimnazit në Mitrovicë. Tani profesor i fakultetit, tani n'fund ka dhanë në Francë ka dhanë frangjisht, Doktor Murat Bejta.

Thotë, më njeh mu prej Shkollës Normale. Thotë, "Xhafer çile derën, çile derën", thotë, "t'hi n'kerr", "Po unë për Skenderaj", "Ka t'shkojsh ti edhe une. Ka t'shkojsh ti edhe une". Ia msym knej për Fushë Kosovë, na nalin. Ia msym për Mitrovicë, plumbat para kerrit na ecshin. Erdh njani e njofti Profesorin Murat. "Profesor", tha, "jeni çmend a?" "Po deshtëm", "Çka deshtët? Shko qaty ku ke nejt mram rri edhe sante se s'bon". E ktheva ata n'fakultet. Kurrë s'kom ditë tani ku ka shku. Unë u ktheva te vllau.

Tani t'nesërmen me niqin mijë peripeti kom mrri në Skenderaj. Vllau nuk erdh. "Jo", tha, "nuk osht' Prishtina e shkijeve po osht' e shqiptarëve. Unë nuk luj prej ktuhit". Edhe nime nuk lujti prej atyhit. Qashtu osht' tregu edhe gjatë kësaj lufte. Ka qenë ni burrë me t'vërtetë si daja Zukë. Ai i gajti dajës jo une (qeshë). E kështu. E kjo puna e...

Anita Susuri: Pastaj a ka pasë arrestim a diçka?

Xhafer Ismaili: Jo, arrestime ka pasë po t'familjes tonë jo. Nuk ka pasë arrestime, malltretime po. T'ju thom t'drejtën une mos me thanë dy javë po muji nuk ka shku pa më marrë mue dhe pa më... më marrshin në Mitrovicë, më marrshin në rrugë, më marrshin... bile, bile masi po duhet me bisedue jeni kaq t'sinqertë ju dhe unë po mundohem me qenë i singert. Ato momente kur mu më rreshin edhe m'lejshin çivita nëpër ftyrë shkojsha te ni Avdyl Miftari në Runikë flejsha, për mos me mi pa fmija çivitat. Ka vdekë ai Avdyli ka qenë ni burrë shumë i mirë me ni gru shumë bujare. Kanë qenë familje shumë bujare. Dyt kanë qenë në arsim kanë punue.

Ni moment une në Turiçec e nisa ni shpi të vogël, atje n'katun. Shkova me marrë diçka erdh ni polic me kerr me më marrë se ato të SUP-it po t'kërkojnë. M'tha ai, nuk e harroj kurrë, Islam e ka emrin ai polic, Islam Lushtaku. Thotë, "Profesor", thotë, "pse kom ardhë unë me të marrë bone naj ekzivazhë ik dika

se po m'vjen keq", thashë, "S'kam Islam ku me ikë". Edhe shkova me të në Skenderaj kishin ardhë ata. A beson që komandiri kur jom ngjit nalt ka kajtë për mue. Komandiri Azem Gashi. Ka qenë komandir se s'kish çka me ba. E dike malltretimet që po m'i bajnë nuk kish çka me ba. "Shko", tha, "zoti të ndihmoftë", edhe ia kom pa lot t'u i shku.

Kom shku nalt edhe ia ka nisë me malltretimet. Ia ka nisë me shuplaka, ma rond ish me t'ra shuplakë se me t'ra me ata pendrekat s'ish nënçmim. Me t'ra shuplakë ishte nënçmim shumë i madh. M'doket qitash e kom atë shuplakën e tij, ishte nënçmim shumë i madh ishte. Ndërkohë m'linte aty mue e shkante dikush atje m'bante ni aheng a e përcillte djalin ni serb ushtar, a pse nuk e di. Shkante pinte atje pinte edhe vinte i pit. Kur vinte i pit ishte edhe ma agresiv. E bon atë vendimin me m'çue në izolim.

Po n'ata t'u nejt e takon ni maqedon që punonte në barnatore në Skenderaj, ai m'njifke edhe nifar' Bronk Rerediçin. Ata i thojnë, "Nuk osht' profesori", ai serbisht e thotë *načitan* (i lexuar), "osht' i kfejllt, osht' i meçem se nuk osht' qysh p'e marrin kta". Vjen ai para meje e shkyn atë vendimin mos me m'çu në izolim. Tash e thrasin atë Islamin me m'kthy ku m'ka marrë. Unë veturën teme e kisha lanë në Turiçec edhe çelsat i kisha lanë e krejt aty. E kisha ni banesë në Skenderaj po s'kisha çelsa. Ni polic, shqiptar ka qenë, ni qen, thotë, "Po ky e ka banesën ktu", thotë, "s'ka nevojë me kthy atje". Thashë, "Unë banesën e kom ktu o idiot po çelsat s'i kom se m'kanë marrë qashtu".

Ky tash, "Pse po i thu idiot policit"? qiky Zoran e ka pasë emrin, ky Zoran e ka pasë emrin udbash i thojshim na i SUP-it, ma qet' kamen. Aty tani i kom ra shtyllës, ka qenë shtylla aty, e kam ba ni çivit edhe jam nisë n'kamë për katun. E kam la, mrizi i thojmë ne, e kom la gjakun. Jom pastru për mos me m'hetu fmija. Kur kam shku e kam gjetë t'shoqen me tanë fminë flejtun jashtë, s'ju kish thanë dikush prej fqinjëve, "Hajde, hini mrena". Pse po maron shpi ky? Çka po i duhet shpija ktu? Banesën e ka. Aty kom thanë, more zot po me m'pasë çu mu sante në izolim çka ish ba me kta fmi t'mi?

Qikjo vajza që osht' tash psikologe kjo ka qenë bebe krejt. Kta tre tjetër i kishin flejt rreth. Kush s'ju kish thanë, "Hajdeni mrena". Kjo m'ka prekë shumë, kjo m'ka prekë shumë, shumë, shumë m'ka prekë. Ka mbetë moment i paharrueshëm. Kom thanë qe, o zot që s'kom shku n'izolim, s'di çka kishin bo kta fmi kshtu. Kshtu ka ksi momente plot ka. Po a din çka m'thojke profesori Pajazit i ndjeri, se m'thojke Xhaferi im gjithë m'ka thanë Xhaferi im. Thojke, "Kur fillon ti me tregu diçka duket shumë e dhimbshme po kur ta tregon ai tjetri del diçka edhe ma e dhimbshme e jotja nuk mbetet kurgjo". Për ata ndoshta shpesh herë edhe nuk osht' mirë m'i tregu.

Kjo ktu te Azemi që ju thashë tri herë m'kanë nxjerrë më kanë pshtu ni Serbezja. Ka vdekë prej kancerit. Ajo gru ka qenë malësore, ajo m'ka pshtu. Ishte një e Pajazit Lajçit aty në Tauk Bashqe. Kta mendojshin aty që osht' shpija jeme edhe kërkojshin pare me maska. Kta kanë qenë magjup të Prishtinës që na kanë plaqkit, sinqerisht po të thom. Edhe...

Anita Susuri: Gjatë luftës kta?

Xhafer Ismaili: Gjatë luftës. Kta... ishte si mur për muri. Po dikush tjetër qitke përpjetë e jo ky që e kishte tytën. Unë thojsha qysh po t'vrajkam edhe s'po t'dhimka (qeshë). Se mendojsha që kjo është t'u kërshit. Tretën herë u ardhë qajo gruja qajo Serbezja. Tha, "Veç ty e kanë vendosë me t'vra". Për fat që s'mi lypshin dokumentat, se me pasë hetu kush jom e tek jom n'vend më kishin likuidu. M'ka marrë m'ka shti në ni furgon, ksi kombi bus që kish pasë veç fmi e gra. M'ka zhdjergë deri te Shkolla Teknike. Aty kom dalë thashë, "Jo ma nuk, ktu unë nuk rri. Po du me dekë ndryshe jo kshtu me fmi". Kom dalë.

Ni Islam Krasniqi, profesor i imi tani edhe kemi punu bashkë. M'kish pa prej dritarës, te Grandi e ka pasë banesën. Thotë, "Skenë ma të tmerrshme nuk kom pa". Se kur m'thanë mu... m'lypshin pare, pare, pare. M'i ran xhamperit të zi me thikë edhe deri n'rryp m'i prejtën pa m'prek në lëkurë. Ajo pjesa tash m'ra krejt edhe m'ka pa Islami gjysmë lakuriq gjysmën e trupit. Thotë, "Nuk kom pa skenë ma të mjerueshme, edhe t'shajshin vazhdimisht". Na shajshin NATO-n na e shajshin edhe neve deri në stacion të trenit. Kur na kanë dërgu në stacion të trenit ajo që ka qenë shumë e dhimbshme që kam emocione me tregu. Ni gru dojke me lind. U deshke m'u bo na rreth me ftyrë tjetren anë për m'i dhanë mundësi me lind (qan). Kjo ka qenë shumë trishtuese. E kshtu.

Anita Susuri: Zoti Xhafer po më intereson tashti folëm për '81-ten edhe m'tregut për rastin që kanë dashtë me ju marrë në izolim. Po qysh ka vazhdu pastaj? Kanë ndodhë domethanë diferencimet edhe osht' bo situata edhe ma e vështirë. Qysh ka qenë për juve me punu me nxansa, studenta n'atë kohë?

Xhafer Ismaili: Ne ai kulmi i revoltës të nxanësve dhe të mësimdhanësve arriti kur minatorët u futën në zgafellë edhe nuk dilnin. Dilnim nëpër protesta. Deri aty sa kemi pasë ardhë n'kamë prej Skenderajit krejt t'u piskat, "Azem [Vllasi]! [Kaqusha \[Jashari\]](#)!", piskatshim. Edhe kishim mundësi me hy në ndonjë mjet po m'thojke daja, ky daja Vehbi thojke, "Nuk t'bohet kabull me shkue si nuk shkon n'kamë nuk ke ba kurgjo". A beson ti që në '81-ten me snajperka prej stacionit të policisë kanë mujtë me na përcjellë neve se si arsimtari te tabela kah shpjegojsha? Se qashtu ka qenë gjimnazi shkolla e nalt stacioni.

Na përcjellshin çdo hap tonin e kanë përcjellë. Fmija shkronin parulla, kuptohet u dufke m'i mshef ato parulla, mos me i pa, sa mujshim. Shkrun nashta edhe dikush tjetër për me na provokue. Deri te rasti kur kta, e kanë politikën e kanë shumë përfide. E nalën shkollën me fmi edhe vet, serbët. "Nuk kemi guxim m'i dërgu fmitë tanë në shkollë sepse janë të rrezikun nga shqiptarët". Tash meqë nuk vinin ata nuk vinin as mësimdhënësit serb aty. Po që e thatë ju shumë mirë e thatë, na shqiptarët. Shqiptari i zi vjen, nxanësit na dolën jashtë protesta, asni fjalë s'e flet shqip veç serbisht.

Thotë, "*Svaki razredni starešina nek izadje kod svoje odeljenje*," "Secili kujdestar i klasës le t'del". Unë i thojsha, "Nuk osht' asni serb ktu, as nuk osht' prej personelit arsimor, as prej nxënësve. Krejt shqiptar jem", thojke "*Ponavljam*" "Po e përsëris". I përsëritke apet qato fjalë serbisht. Edhe sot ia majnë patriotat ma t'mdhej ata. Disa. Kjo mu më, shumë më mërzit në të vërtetë. Aty ishte rasti që Hamza kërkoj, Hamëz Jashari, me ia qit' nxanësit jashtë edhe me mbajtë ni fjalim para nxënësve. Po nuk e

disha që edhe pse s'osht' Ivani aty, ni zëvendës drejtor serb, i ka sejmentët aty. I kishte sejmentët shqiptarë. Gjoja i kishin tregu atina se për protesta Xhaferi ia ka qit' Hamzës nxanësit jashtë se i ka kërku Hamza.

Anita Susuri: Veç ta kuptoj '81-ten a '89-ten?

Xhafer Ismaili: Kjo osht' kur kanë hi në zgafellë minatorët.

Anita Susuri: '89-ten.

Xhafer Ismaili: Se edhe Hamza punonte në fabrikën e municionit hala e fabrika e municionit ishte bashkë me Trepçën ishin ato. Bile ni rast po ju thom pak qishtu se kishim edhe raste kshtu humor. Ni minator kishte qit' fjalën që i ka vdekë gruja edhe nuk ka dalë prej zgafelle me dalë me varros. Dy kolege t'mija m'kishin rrethu mu edhe, "A dëgjove profesor? A dëgjove? I ka vdekë gruja edhe s'ka dalë m'i vorros. Çka kishe bo ti?" Bile ajo osht' ni profesoreshë shumë e nderune, e Bujanocit osht' që ka punu te na, ni Qezibane Qazimi. Shumë gru e mirë, shumë ni zojë e mirë, msuse e mirë.

Tha, "Ti çka kishe bo ti?" thotë. Thashë, "Jo unë kisha dalë", "A patrioti që m'je". Thashë, "Po ju s'po m'pytni pse kisha dalë?" "Pse?" Thashë, "S'kisha besu që u dekë pa e pa me sytë e mi" (qeshë). Tha, "A s'je as për qata". S'je as për qat' gru demek. Kemi pasë kso se s'kishim qare pa pasë edhe ksi momentesh se ishim lodhë prej atyne parullave. Ni kohë i rujsim edhe shkollat se po na shkrujnë parolla e sene. Kish njerëz që e marrshin me shpirt ngurtësi shumë t'madhe atë se mos po na ndodhë diçka. Unë flejsa valla. Le të shkrujnë s'kishim çka me ba, s'munesh m'i nalë ti ato. I shkrujnë, i shkrujnë.

Kish asi që i marrshin me shpirt ngurtësi shumë t'madhe. Me shkrujtë ni parollë mendt i lajshin. Besa kishte pak si humor kishte shpesh herë kur na vijshin kta me i kontrollu parollat u kanë ni Sadik Ahmeti gjuhëtar. Kur e lexojshin aty Kosova Republikë ai Sadiku thojke, "Paska haru ni pa za me ia qit' aty". Ata thojshin, "S'jena ardhë na m'i kontrollu gabimet ortografike" (qeshë). Po kshtu ka pasë kso...

Anita Susuri: Ju keni qenë t'u punu në Gjimnazin Ramiz Sadiku atëherë?

Xhafer Ismaili: Po, po.

Anita Susuri: Domethanë gjimnazi ka qenë, çfarë lloj gjimnazi?

Xhafer Ismaili: Ka qenë i shkencave natyrore edhe i shkencave shoqërore. Po ka qenë edhe niherë ka qenë ni mësim orientum i thojshin. Ka qenë dy vjet ka qenë gjimnaz i përgjithshëm kshtu, pas dy vjetëve orientoheshin, për qata ka qenë i orientun. Orientoheshin në profesione. Profesione orientoheshin. Nuk pat' sukses shumë.

Anita Susuri: E Fakultetin e Edukimit që ke dhanë psikologji kjo ka qenë në të '90-tat?

Xhafer Ismaili: Në fakultet mas '96-tes. Vonë kam ardhë në fakultet, shumë vonë kam ardhë.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Po m'intereson tashti për gjimnaz sa keni qenë, qysh ka ndodhë që ju kanë largu? Qysh ka qenë qajo ditë? Si e kujtoni ju? Qysh ka ardhë deri te qajo ditë?

Xhafer Ismaili: Unë, do të përqendrohem ma shumë në aspekt tjetër nga ato aspektet që i shpjegojnë që kemi punu në shtëpiat shkolla, shtëpiat private nëpër fshatra. Kemi punu në Turiçec, në Likovc, në Rezallë, në dy Klinat, në Vorinikë kemi punu. Po ajo bujari që e kanë tregue fshatarët, ata që i kanë lshu shpijat osht' e paharrueshme. Bile bile unë atyne ua kisha shkrujtë nëpër shpijat e tyne, shpija e qëndresës, e rezistencës. Se ata e kanë dhanë provimin. Unë duke qenë pedagog i shkollës nuk isha shumë i orientun kah lokalet ku po mbajnë mësim ose përveç atyne që isha.

E kisha në preukopim tjetër, e kisha preukopimin si duhet ta organizojmë procesin mësimor në shkollat e okupuara. Bile e kam në shkrim atëherë Bujku dilke, e kam, 'Si ta racionalizojmë punën mësimore në shkollat e okupuara'. Qashtu titullin e ka në artikull shumë i gjerë. Ka qenë se ktu ka qenë halli edhe jo vetëm i shkollës time. Artikulli ishte në mesazh për të gjitha shkollat se si duhet ta racionalizojmë punën tonë në shkollë se nuk i kishim ato lokalet që i kemi pasë, nuk e kishim atë shkollë që e kemi pasë, nuk e kishim atë kohëzgjatje të orës mësimore që e kishim pasë. Kishim gjithçka të reduktun edhe u dashke edhe plan programet m'i reduktu, u dashke edhe njësitë mësimore m'i reduktu. U dashke edhe punën tonë të përgjithshme me reduktu.

U dashke me kërkun ndihmë. S'pari prej Katedres Pedagogjike që ishte grumbullimi ma i madh i kuadrit në Kuadrën e Pedagogjisë. Me kërkun nga institucionet tjera, nga Enti Pedagogjik u dufke me kërkun. U dufke me kërkun ndihmë edhe prej prindërve. U dashke në bashkëpunim ma i madh edhe prej prindërve. Me ju thanë prindërve që atë që nuk po munden me realizu fmitë e juj' në shkollë realizone në familje. Ajo që po mbetet gjysë, vazhdone atje në familje. U dufke me i reduktu edhe njësitë mësimore, edhe punën mësimore edhe orët mësimore. Kjo ka qenë ma preukopim i imi. Preukupim kryesori ka qenë ajo se si ta racionalizojmë punën tonë mësimore me nxënësit në shkollat e okupuara.

Dilte zani im, u dëgjojke zani im. Kta bonën edhe ndryshme në plan programe. Kta hoqën prej plan programeve shumë njësi mësimore. Hoqën gati krejt letërsinë. Ato të Shqipërisë nuk guxonte me i pa kush ma me sy. Bile më kujtohet e mbajtëm në mbledhje për bërthamat e përbashkëta, quheshin bërthama të përbashkëta. Ktu në Sami Frashër. Bashkë krejt. Unë u çova thashë, "Gjithçka kishit parapra muzikë veç asni valle, asni kangë s'e kishit parapra shqipe. Na shqiptar jem". U çu njëni, nuk po

du me përmend emra se s'kom qef m'i lëndu njerëzit. Po me ardhë puna kshtu fort fort edhe përmendet emri.

Thotë, "Gjuha shqipe", thotë, "osht' e mirë boll. Na boll kemi në gjuhë shqipe. Serbishtja i ka puntë keq", "Pse i ka serbishtja puntë keq?" Tha, "Pse p'e jep serbishten gjithkush", tha, "veç po shkon po e blen indeksin në librari po i regjistron gjuhën serbo kroate edhe po shkon po jep mësim gjuhën serbo kroate". Edhe u shpreh serbisht, tha, *"Došlo je vreme da kukamo za srpsko-hrvatski jezik"* "U ardhë koha me vajtue gjuhën serbo kroate". Ni femër serbe i tha, *"Kukajte za tvoju platu"* "Vajto ti rrugën tane". Shumë mirë ia bani. Ka pasë kso momente shumë shumë...

Ajo mandej rashim në shumë nëpër prita të ndryshëm për furnizimin e shkollës me materiale. Për shembull unë e di ni rast kom ardhë m'i marrë ditarët edhe dëftesat e para që kishin dalë me atë flamurin shqip, me shqiponje. I mbushi dy thasë unë me ditar, thasë t'letrës. S'guxojsha me hy n'autobus se na kontrollon dikush. Pritsha aty te nënkalimi që është rruga për Fushë Kosovë. Po vjen njëni aty që e qujshin tan shpihun i thojshin. "Shpihun, shpihun është ai". Po vjen me ni llad, me ni kerr edhe po m'sheh mu me ata thas. "He profesor, çka ke aty?" "Gazeta kom marrë se ni djalë po punon n'shitore atje s'po ka me çka m'i pshtjellë artikujt, kom marrë gazeta". "Hajde, shtini ne kepek".

I shtim ne kepek edhe kur shkum atje në Skenderaj ai nuk po m'çon te banesa po po m'çon drejt te shkolla. "Hajt", tha, "se nuk jom budallë unë e di çka ki aty po dashta me ta bo qit' t'mirë". A tan i thojshin shpihun atij. Ia di për nder shumë (qeshë). Po m'çoj me ata thashë me ditar. M'çoj në gjimnaz aty. Kishte ksi momente...

Anita Susuri: Po m'intereson kto kjo dita që ju kanë largu prej shkollave qysh ka qenë? A ka ardhë policia apo jeni largu vet?

Xhafer Ismaili: Na e lshum punën, na e lshum punën edhe punojshim në të zezën. Punojshim jashtë lokaleve. Jo s'na kanë lanë lokale, i kanë blloku lokalet. S'kanë lanë kërkond me hi n'lokale.

Anita Susuri: Policia ka qenë n'shkolla?

Xhafer Ismaili: Policia, policia. Aty s'kemi pasë ma as n'oborr t'shkollës s'na kanë lanë me hy. Ajo ka qenë rreptësisht e ndalune prej tyne. Se na kemi ba përpjekje, disa herë kemi bo përpjekje me hi, disa herë. Jo... me dhjetra herë kemi bo përpjekje me hy po kemi dështu se s'na kanë lanë me hy.

Anita Susuri: A keni marrë pjesë pastaj në ndonjë mbledhje ku osht' përcaktu se cila shpi me shku ose si me vendosë me punu ma tutje?

Xhafer Ismaili: Po aty ni kontribut shumë t'madh e ka dhanë Lashi. Ata ka pasë, ata i kanë pasë njësitë e veta nëpër të gjitha komunat edhe çdo komunë ka bo organizimin. Bile e kemi pasë ni Xhafer Murtezi

aty ka qenë organizator shumë i mirë, i punës. I bajshim ato planet ku me shkue nëpër fshatra, nëpër shtëpija. Shtëpijat, familjet jo vetëm që na kishin lshue lokalet po edhe na jepshin moral, na jepshin edhe bukë se e dishin që ne s’kishim ku me u ushqy nëpër fshatra. Sjellshin edhe ushqime. Ushqime të ndryshme na sjellshin.

Kanë qenë shumë solidar, kanë qenë shumë solidar, sidomos dy Klinat nuk i harroj kurrë. Kjo Klina afër Skenderajit... krejt edhe Likocë edhe Zalla edhe kanë qenë shumë mikpritësa, shumë na kanë ndihmu, shumë na kanë ndihmu. Po e thom, “Pse edhe tash nuk jem qashtu solidar? Pse s’kemi vazhdu edhe tash me qenë të tillë?” Po i harrum të gjitha, s’di pse i harrova aq shpejt. Kjo osht’ ni sindrom i pa shërueshëm i joni.

Anita Susuri: A ju kujtohen emrat ose familjet, mbiemrat?

Xhafer Ismaili: Jo, të atyne familjarëve për fat të keq nuk më kujtohen për nder nuk më kujtohen. Janë librat janë në libra të gjithë ata emra që nuk më kujtohen.

Anita Susuri: N’sa shtëpi keni punu me ju? M’tregut nëpër fshatra?

Xhafer Ismaili: Po kemi punu në Likoc, në Rezallë, në Polac, në dy Klina Klinën e Epërm edhe Klinën e Ultë, në Çubrel, në Runikë po se po, Turiçec. Domethanë gati në të gjitha bashkësitë lokale po shpesh herë jo në ato ku ka qenë bash bashkësia lokale se edhe aty na pengojshin po në fshatrat përreth bashkësive lokale. Domethanë gati në të gjitha. Po ne i kemi shfrytëzu edhe shkollat fillore, se diku diku shkollat fillore nuk i kanë pengu. I kena shfrytëzu edhe lokalet e shkollave fillore aty ku nuk kanë pengu.

Anita Susuri: Cilat vende a ju kujtohet kanë qenë shkollat fillore?

Xhafer Ismaili: Po, kanë qenë Turiçec, Leqinë, Orinikë, Runikë, Likovc, Rrezallë.

Anita Susuri: Sa ka qenë e vështirë për juve me udhëtu brenda javës nëpër krejt këto shkolla me arritë me shku?

Xhafer Ismaili: E thashë parëz solidariteti ka qenë shumë i madh, solidariteti në nivel, na ka ndihmu shumë. Mu m’ra kur erdha në Prishtinë me shku prej Prishtinës në Turiçec. Prej... na çojshin me kerre private. Nipi i drejtorit, i drejtorit që e kishim në gjimnaz na çoj në Turiçec. Na kthej, e vrajtën. Posa na kthej neve e vrajtën. Po nipi i Hamdi Nuredinit. E vrajtën vetëm pse ai na kishte bartë neve me na çu atje në Turiçec me mbajtë msimin. E vrajtën ni djalë t’ri, ishte shumë e dhimbshme.

Anita Susuri: A ju ka ndodhë, sigurisht ju ka ndodhë me ju ndalë edhe juve policia diku?

Xhafer Ismaili: Po neve na kanë ndalë shpesh edhe shpesh herë kanë tentue qaq keq me na edhe rrobat me na hjekë, me na lakurique. Po ne me këmbëngulje thojshim, “Jo, çona në stacion të policisë, atje deshna n’rugë jo. Muni me na vra”. Se tentojshin me na deshë krejt, me na hjekë teshat. Ka qenë gjoja po kërkojnë diçka te na që kem diçka, në atë kuptim. Po ne nuk pranojshim. Ni gja të tillë nuk e kemi pranë kurrë.

Ka pasë raste bile, ka pasë raste ku bash Vehbinë e rrehen shumë rrugës t’u kthy prej shkollës. I ran n’vesh edhe tash ka qenë ni Sejdi Koca, ka qenë ni veprimtar shumë i madh. Vjen me pa Vehbinë që e kanë rreh policia. Po i thotë, me ngushëllu po i thotë, “Vehbi mos ta nin veshi”. Ky po i thotë, “Bash veshi po m’dhem” (qeshë). Ka pasë kso momente që u deshke kaniherë, çka me bo.

Na nxanën niherë në Deçan t’u festu ditën e shpalljes së republikës 7 shtatorin. Deshtën me na marrë të gjithë, me na çu në polici. Fati që unë kisha leje të njoftimit 7 shtator i lindur. Ua dërgova letërnjoftimin thashë, “Na jena ditëlindjen teme t’u festu se jo ditën e republikës”. Ka qenë ksi raste, kemi pasë plot.

Anita Susuri: Po m’intereson për shtëpitë ku osht’ mbajtë mësimi. Çfarë gjendje kanë qenë? A kanë qenë sado pak të përshtatshme?

Xhafer Ismaili: Aty ku i kishim shkollat fillore nuk kanë qenë kushtet e randa, s’kanë qenë kushtet. Kurse në këto shtëpitë po valla. Fmijet janë ulë ma shumë n’blloka, në blloka të ndërtimit, ndërtimtarisë. Na ndihmojshin fshatarët i bojshin do karrika, do sene. Na ndihmojshin shumë. Shumë na kanë ndihmue, shumë. Pa përtes na ndihmojshin. Ishin kushte t’rana, ishin kushte t’rana po vullneti shumë i madh.

Bile çka po shoh unë disa pedagog (bën me thojza). “Pse po thojnë atëherë osht’ punu ma mirë se tash”? Nuk osht’ punu ma mirë se tash po entuziazmi ka qenë ma i madh, vullneti ka qenë ma i madh. Se na edhe me pasë dashtë s’kishim mujtë me punu ma mirë se tash se s’kemi pasë kushte, s’kemi pasë. Megjithëse edhe tash këtu kushte që i kemi, kushte ma shumë fallco. Fallco që po mundohemi na me imitu tjetër e s’po dijmë se s’kem kushte m’i imitu tjetër.

Tash m’i sha kta e thojnë mësimi gjithë ditor. Nuk ka mësim gjithë ditor, ka qëndrim gjithë ditor n’shollë. Qëndrim po se mësim gjithë ditor nuk ka dhe nuk kemi me pasë kushtet e favorshme për ni punë të tillë. Po nashta masi ka fillu bohet diçka.

Anita Susuri: A ka pasë shumë klasë që kanë qenë të shpartallune në shtëpi të ndryshme?

Xhafer Ismaili: Kemi pasë. Gjimnazi i ka pasë n’atë kohë 2000 nxanës. Më shumë se 2000 nxanës i ka pasë, ka pasë shumë. Po bile m’kujtohet ni rast se na i rrehshin nxanësit. Ishte ni rast kur drejtori jonë u

rrzu prej çershisë u pat' rrzu t'u e krasit edhe shkoj n'spital. Metëm na si zavendës të tina, zavendës drejtori kaniherë nuk ishte as zavendës drejtori u dashke pedagogi me u marrë me ato punë.

Ma bijnë ni nxanës që e kishin rreh policia. E kishin rreh në Ribizla. Ribizla që i çojshim nxanësit. Ai del sulmues e knojnë kta nxanësit e lavdrojnë që ka dalë sulmues. Ai polici i afrohet dhe e rreh, nifar' Zorani ka qenë, i Istogut ai polici. Vjen ni shërbëtor i shkollës aty, se vijnë tani nxënësit qashtu qysh kanë qenë me ato veglat që kanë punu, vijnë para derës. Po vjen ni shërbtor ka qenë boshnjak. Po thotë, "Demonstracia, demonstracia", mu po m'drejtohet. Thashë, "Jo s'ka demonstrata jo". "Qyre kanë ardhë nxanësit".

Dola unë. "Çka u bo?" Po m'tregojnë qishtu, qishtu. Nuk i kishte as dy-tri ditë ma përpara që ma kishin rreh edhe ni nxanës. Po atë nxanësin që e kishin rreh ishte i Vojnikut, ishte ni kusheri i kryetarit të komitetit. Ni Musë Draga shumë burrë i fortë, shumë burrë i mirë. Ka qenë kryetar i komitetit n'atë kohë po shumë burrë i mirë. Ai ka ra edhe na kena shpëtu prej shumë seneve t'kqija aty n'komunë. E thërras unë kryetarin e komitetit.

Unë si intim me to thom masi ia kanë rreh kusherinin tash m'del përkrahi e pak unë si trim i thashë, "Shok kryetar", atëherë shok, thashë, "ma kanë rreh edhe ni nxanës. Që nuk ndërmerrni diçka, unë nesër kom me dalë me 2000 nxanës në protestë". Asni fjalë nuk e ka folë, veç e ka lshu telefonin. Po pa u bo 15 minuta u ardhë krye shefi i policisë. E kish çu krye shefin e policisë. Erdh nifar' Avdi Behrami. I jam mirënjohës për atë rast. Vjen edhe thotë, "Ku janë ata nxanës?" Unë gjak nxeht po flas shumë, po ai shumë but.

Tha, "Ani këtë nxanësin që e kanë rreh le t'vjen n'zyre kta le t'shpërndahen". Shkojmë na n'zyre edhe i thotë, ia merr deklaratën atij nxanësit. Kur thotë ai nxanësi, "Kom dalë sulmues", thotë, "Çfarë sulmuesi ti? Kur t'ka ra ai edhe ti u dashtë m'i ra". Thashë, ky e ka menen me na provoku, sigurisht po don me na provoku naj sen, po jo. Tha, "Hajt shko dil ti". M'kthehet mue, thotë, "Ti", thotë, "çfarë fjalori ke përdor me kryetarin e komitetit?" Thashë, "Qita po ta thom edhe ty që s'ndërmerrni diçka unë ka me dalë të hanën", e shtune ish, "me 2000 nxanës n'rugë".

Ia hini tavolinës tha, "Vallahi s'je dalë". Thashë, "Vallahi jom dalë". Veç unë e ai n'zyre. Dikur tha, "Vallahi s'je dalë se atë polic sante ka me suspendu", edhe qashtu ndodhi. Qat' natë e ka ndesh atë polic dhe i ka kushtu kjo punë atij shumë i ka kushtu. Po e suspendoj atë polic. Po kjo osht' e paharrueshme kshtu. Ka qenë i keq ai polic i Istogut, ka malltretu shumë njerëz ka malltretu në Skenderaj.

Anita Susuri: A ka ndodhë që edhe naj parollë e policisë ka kalu andej me qëllim ose ka hy brenda?

Xhafer Ismaili: Jo brenda nuk m'kujtohet që ka hy ndonjë patrollë, me kalu po, kanë kalu aty pari. Kanë kalu edhe besa kanë qenë nënçmues t'mdhej. Shpesh herë edhe na kanë gjujtë me fjalë. Kur

kemi mbajtur ndonjë mësim që nuk ka zgjatë shumë shpesh herë na kanë thanë “*Kakva je to nastava?*” “Çfarë mësimi është ai? Ju keni mbajtur një mbledhje se mësimi zgjat ma shumë jo aq shkurt”.

Për ata shpesh herë kërkojsha prej mësimdhënësve që mundësisht t’i mbajmë ortë ashtu qysh i kemi mbajtur edhe nëpër lokale, po ishte e pamundur pa i reduktu kapak. Besa edhe nuk guxojshim me u vonu aty shumë ndërrimi i masditës, nuk guxojshim m’i terru nxanësit shumë se frikësoheshin me u kthye...

Anita Susuri: Sa ka zgjatë në orë mësimore?

Xhafer Ismaili: Po nër’ 30 minuta nuk ka zgjatë, 35, 40 nuk kemi pasë mundësi. Nuk ka pasë mundësi.

Anita Susuri: E qysh ka qenë për shembull gjendja e nxanësve? Ju si e keni pa si mësimdhënës? A kanë qenë të pregaditur për mësim? Qysh e kanë përjetu ata për shembull? Ju si e keni pa prej këndvështrimit t’juj?

Xhafer Ismaili: Po arsimtarët, stafi mësimor kurrë nuk ka qenë ma vigjilent se u deshke me qenë i tillë. Se u deshke përveç mësimi e kishin edhe atë kujdesin ndaj fëmijëve, ndaj nxënësve se çfarë po ju ndodhë rrugës. Djali i Adem Jasharit ka qenë nxanës te na n’atë kohë. Atëherë ai vinte i armatosur, u deshke na me u kujdesë për armën e tij, Fitimi. S’ka pasë asi djali, e kanë vra. S’ka pasë asi djali, hiç s’ka pasë asi djali. Edhe trim, edhe i bukur, edhe nxanës i mirë. E kanë vra edhe ata.

U deshke na me pasë kujdes ndaj tyre. U deshke me pasë kujdes sidomos ndaj familjes të Jasharajve se ishin n’shënjestër ishin, fëmijë të tyre. Kshtuqë...

Anita Susuri: A kanë pasë për shembull libra? Fletore mjaftueshëm?

Xhafer Ismaili: Libra nuk kanë qenë pa libra, kanë qenë të furnizun me tekste. Tekstet nuk na kanë mungu. Tekstet vetëm ata që nuk kanë dashtë m’i marrë se ka pasë libraria, kanë qenë me tekste. T’rralla kanë qenë ato lëndë mësimore që nuk kanë pasë tekste. Për shembull psikologjinë që unë isha edhe pedagog i shkollës edhe jepsha psikologjinë. Unë u deshke arsimtari vet m’u interesu m’i gjetë tekstet.

Unë erdha në Prishtinë e luta profesorin Neki, Neki Juniku ish autor i asaj psikologjisë dhe profesori Pajazit. Ata pa pagesë pa kompenzim na dhanë disa ekzemplarë dhe i fotokopjova ua dhashë nxanësve. U deshke vet arsimtari m’u kujdesë për tekstet shkollë me i furnizue dhe e bojshin atëherë arsimtarët. E bojshin me kënaqësi, pa përtës e bojshin. Sepse ishte ajo kohë që më një anë nuk e bojshim atë, në një anë e bojshim për hir të nxanësve, në anën tjetër e bojshim për t’ju kundërvu atyne. Për t’ju thanë atyne që edhe n’kohë të okupimit na dijmë me jetu, dijmë me mësu, dijmë me punu.

Anita Susuri: A ka pasë ndonjëherë ndonjë problem që u është shfaqë ose prej nxanësve ose prej mësimdhënësve diçka? Si keni mujtë me gjetë zgjidhje?

Xhafer Ismaili: Ti po i bon pyetjet sikur me pasë bisedu ma përpara (qeshë). Osht' ni rast tash po ju tregoj. U rrehën nxanësit serb me nxënësit shqiptar në Runikë. Ajo paralelja në Runikë ka pasë serb. E kishin dërgu si aktiviste Vahide Hoxha, shoqën e Fadil Hoxhës, si aktiviste për atë ngjarje që kishte ndodhë aty. Ajo ni gru zojë, ni gru e pa krahasueshme. Ni gru Albright. Erdh edhe fillun kta. Kishte aty komunistë që kishin dëshirë kur ndodhin kso ngjarje me u tregue ma katolik se papa. Me u tregu se neve na dhimbësin serbët, me u tregu se kshtu.

Çoheshin folshin. 'Çka ka ndodhë, kjo s'ndodh kërkund, e qysh m'i rreh serbët, e qysh kshtu. Qenin e serbëve s'guxojmë na me rreh, na duhet kshtu, na duhet kshtu'. Gati na nxuni gjysa e natës kaloj. E mora fjalën unë. Thashë, "Kjo që ka ndodhë na ndodhë shpesh herë edhe ndaj shqiptarëve me shqiptarë na rrehen. S'ka ndodhë kjo me kurfar' prapavije. S'ka ndodhë pse ata kanë qenë serb e na shqiptar. Kjo ka ndodhë krejt rasësisht. Na mundem m'i dhanë ngjyra çfare doni po kjo nuk ka kurfar' ngjyre politike, as urrejtje nacionale as kurgjo nuk ka".

U kry mbeldhja edhe dolëm me Vahiden edhe me dy profesor, me ni t'fizikës i ndjerë Rustem Sejdiu edhe qiky Avdyl Miftari, dyt të ndjerë janë tash. E morëm Vahiden. Kishte qenë ni kafe ende t'u punue, hynëm me pi kafe edhe bisedojshim me Vahiden. Vahidja tha, "Na nxore prej krizës. Pat' me na nxan", tha, "sabahu mos te morre fjalën ti". Thashë, "Po i nxora prej krizës". Po vazhdojmë na qashtu. Unë kisha qef me vazhdu hala. Ai Avdyl Miftari profesor i historisë ish. Tha, "Oj shoqja Vahide", tha, "ky Xhaferi ka qef ton naten me nejt qitu se s'ka ku shkon, s'ka banesë, s'ka kurgjo". Më kqyri, tha, "S'ki banesë"? Thashë, "Nuk kom". Tha, "Ki me pasë". Intervenimi i saj ka shku te Musli Draga edhe m'ka dhanë banesë. Kishte qenë shumë shumë e zoja. I erdh mirë ajo që e përmbylla ata. U deshke qashtu me përmbyllë.

Kemi pasë raste tjetër nxënësit ndodhke prej mos kujdesjes të arsimtarit revoltoshin e lshojshin orën. Po në Runikë ka ndodhë ni profesore ishte. Ajo pa qëllim ka thanë, "Sot nuk kemi për Naimin". Nashta kjo ka thanë, "S'ka ma", qysh thojshin nxënësit, "s'ka ma për Naim e për Migjen", edhe ia kanë lshu orën. Ajo e kishte vllaun profesor të fizikës dhe vjen ai thotë, "Ia kanë lshu orën motrës".

Dal unë i marr nxënësit thom, "Kush s'guxon as Filipin, as Ndre Mjedën, as Migjenin askënd prej autorëve shqiptarë me na hjekë prej planprogramit. Po msusja ju' profesoresha ju' ka thanë, 'Sot nuk kem për ta. Sot qit' orë mësimore kem diçka tjetër e jo për ta'. E ju e keni marrë që nuk kemi kurrë për ta". Hynën mrena nxënësit, u stabilizun. Kishte... unë si pedagog kom pasë plot peripeti aty. Djali i vet arsimtarit që ka punu aty ka ardhë me thikë n'dorë n'koridor.

I ka thanë kujdestarit të tij, “Ti dili përpara se je kujdestar”. Thotë, “Jo more. Babën e vet e ka ktu le t’i del baba”. Ai thotë, “Nuk guxoj u mësu m’i pre delet më pret edhe mue n’qafë”. Kom dalë. Shumë interesant. Kom shku drejt n’to i kom thanë, “A po ma jep qat’ thikë?” Ai me ni za shumë t’lartë m’thotë, “Po”, mue edhe unë thashë ky sigurt do me ma dhanë. Po e kthej tehin prej veti, levën prej meje edhe ma dha thikën. Ka pasë raste shumë shumë interesante, ka pasë. Si pedagog unë kom...

Vjen ni i njofshëm i vllaut tem ni shtagë të hekrit dhe u njifke atje nifar’ Imeri, u njifke si ish boksier edhe shumë i rrezikshëm. Vjen po e dojke vllaun tem. Vjen me atë shtagë të hekurit dhe unë m’thojnë, “U ardhë Imeri dhe u ardhë filan profesori nuk dal pa e përgjak prej ktuhit se ma ka rreh djalin”. Dal unë i thom, “O Imer!”. Thotë, “Urdhno?” I thom, “Ti duhesh me bajtë naj shtagë të drunit që edhe me ta nxjerrë naj kush prej dorës me të rreh me dru ma lehtë e ki, me ta nxjerrë kta...” ia nisi po kesh. “Pasha zotën”, tha, “ma hoqë idhnimin se jom ardhë qishtu me bo veç me qito fjalë ma hoqe”. U kthy te shpija. X, x kso raste kemi pasë.

Anita Susuri: Po m’intereson edhe osht’ ni temë pak e randë për helmimet e nxanësve. A kanë ndodhë? Çka keni pa?

Xhafer Ismaili: Jo veç që ka qenë e ranë po ka qenë ajo që ma së shumti na mërziste dhe na bënte me u ni keq që akoma kishte njerëz që nuk besonin. Kom pasë unë aty ni punëtor që thoshte, “Jo bre po kamuflojnë, po aktrojnë”. “Jo bre s’po aktrojnë”. Po nuk kaloj shumë kohë vajza e tij u smu. Thashë, “Kjo vajza jote po aktron?” Nuk ishte aktrim, ai ishte helmim, helmim shumë i madh. Kerret e arsimtarëve kanë qenë t’u bajtë t’u çu n’spital. Kerri jem s’ka pushu kurrë t’u çu n’spital fmi. Ajo ka qenë e tmerrshme. Ka qenë shumë e tmerrshme. Ka ndodhë, te na m’doket ka ndodhë ma së shumti në Skenderaj. Ma së shumti ka ndodhë helmimi në Skenderaj.

Anita Susuri: A ju kujtohet hera e parë kur keni pa ndonjë rast?

Xhafer Ismaili: Po herën e parë e kanë... herën e parë na kemi mendu se naj helmim aty, bile pyetshim mos ka qenë kjo vajza në laborator dikund të kimisë mos ka qenë në kabinet të kimisë? Po, jo, jo. Hera e dytë e treta tani u shpeshtun rastet shumë, shumë kish.

Anita Susuri: Çfarë simptoma kishin?

Xhafer Ismaili: Ka qenë simptomë fryme, kishin ngulfatje. Nuk... ju zinke fryma. Ato lëvizjet që i bojshin me kam edhe me dur ishin të tmerrshme m’i pa. S’mujsh me zapu, s’mujsh me qetësu, s’mujsh me ia nalë ato lëvizje të durve dhe kamve. Ka qenë me t’vërtetë shumë e tmerrshme ka qenë. Falë personelit arsimor që janë kanë shumë t’kujdesshëm. S’ka kursy askush as kerr, as mund. Krejt profesorët kanë qenë t’gatshëm me kerre si i rroke helmimi meniherë i çonim n’spital.

Po edhe spitali nuk dishin çfarë diagnoze m'i dhanë, edhe ata kishin probleme. Mirëpo ajo që i çonim në spital sado pak i qetësonte ata se jom n'spital, jom te mjeku. Sado kudo i qetësonte. Kshtu valla, kshtu ka ndodhë. Kto kanë qenë trishtuese shumë...

Anita Susuri: A ka pasë shumë? A ka pasë ma shumë vajza a djem?

Xhafer Ismaili: Ma shumë vajza, interesant, ma shumë vajza. Po edhe numri i vajzave ka qenë ma i madh i vajzave n'gjimnaz se i djemve po kryesisht vajzat ma të ndishme kanë qenë ndaj këtij helmimi.

Anita Susuri: A keni pa ju për shembull diçka të dyshimt ose që ka kalu dikush i dyshimt që ka mujtë me bo?

Xhafer Ismaili: Jo. Aty ajo ishte krejt... e keqja ma e madhe ishte që s'kishe çka me thanë, s'kishe kujt me i thanë, s'kishe kond me rrok për gjyksi që ndodhi kjo. Ajo ishte e keqja ma e madhe. Se me pasë diqysh... aty kanë qenë përgaditje para përgaditje shumë e madhe për me vepru. Aty kanë ba përgaditje shumë t'madhe para se me ndodhë ajo. Se kanë qenë shumë misterioze ka mbetë ajo, edhe sot, po helmim ka pasë.

Anita Susuri: A e dini për shembull në spital a kanë bo naj ekzemplar? E di që s'kanë arritë me dërgu dikund për...

Xhafer Ismaili: Nuk kom, nuk kom asni informatë që diçka të tillë kanë ndërmarr mjekët ose spitalet, jo.

Anita Susuri: Sa ka zgjatë kjo periudha domethanë që janë smu vazhdimisht?

Xhafer Ismaili: Fatbardhësisht nuk ka zgjatë shumë. Fatbardhësisht nuk ka zgjatë shumë. Me thanë ni muj ndoshta ma pak ndoshta ma shumë, nuk ka zgjatë. Se...

Anita Susuri: Si jeni ndje për shembull ju di pegadod si mësimdhënës i ktyne?

Xhafer Ismaili: Osht' e papërshkrueshme si jemi ndje. Ata ishin fmi tantë. Ata ishin ma shumë se fmi tantë se ishin edhe tantë edhe t'hujë. Ni përgjegjësi ishte ma e madhe kur e menojshe që nuk janë tantë. Kishe ni përgjegjësi ma t'madhe naj prindërve. Kishte prind që e kishin t'vetëm fmi që e kishte t'vetmën vajzë apo t'vetmin djalë. Kur e pake n'atë gjendje ishte me t'vërtetë tmerr.

Anita Susuri: Sa ka mujtë për shembull mësimi me rrjedhë normal në kushte të tilla?

Xhafer Ismaili: Çrregullohej mësimi, procesi mësimor çrregullohej. Sepse edhe ata fmi që nuk ishin të prekur nga helmimi nuk e kishin ma përqendrimin në mësim, ishin të preokupun me atë frikën e

helmimit, ishin të shqetësuar për kolegët, për shokët e tyre që i shihshin në atë gjendje. Nuk kishte ma atmosferë mësimi as për mësimdhënësit as për nxënësit. Ky ishte qëllimi i armikut, kshtu me ba edhe arriti.

Anita Susuri: A i vizitojshi pastaj? Pas sa kohe u stabilizojshin ata?

Xhafer Ismaili: Ata vishin vet na u lajmërojshin se janë ma mirë. Vishin vet nxanësit. Shumë t'mirë. Vishin vet na lajmërojshin që janë ma mirë.

Anita Susuri: A u kthejshin shpejt në mësim apo ju dufke kohë?

Xhafer Ismaili: U kthejshin në mësim, nuk u vonojshin u kthejshin në mësim. Edhe prindërit na falënderojshin për kujdesin që e bojshim për ta.

Anita Susuri: M'thatë që '96-ten keni fillu edhe në Fakultet të Edukimit...

Xhafer Ismaili: '96-ten punojsha edhe atje edhe atje, prej '96-tes.

Anita Susuri: M'tregut që ka qenë pak e vështirë për juve po a ju ka ra me ardhë shpesh gjatë javës në Prishtinë e me u kthy në Skenderaj?

Xhafer Ismaili: Po ne e kishim orarin, e kishim orarin. Mu m'vinte keq me e lshu atje, m'vinte keq. Po edhe m'vinte keq me shkrujtë titull aty doktor. Çka me shkrujtë atje? M'vinte keq me ju thanë atyne se po iki prej ktuhit se kisha nostalgji. Dy vjet në Turiçec e aty gati 27 vjet isha. Kshtuqë atë ditë kur ju thashë, "Unë po e marr rrogën", ishte ajo rroga sekondare edhe primare në qoftëse punon ni vend. Ma mirë isha me marrë kta primare se ish ma e marre rroga. Po unë e marrsha kta sekondare. Ni moment u ngarkova me shumë punë ktu, u ngarkova me disa programe...

Anita Susuri: Në Prishtinë?

Xhafer Ismaili: Në Prishtinë. Edhe m'u desht me shku me ju thanë, "Unë nuk punoj ma ktu". Ishte rast shumë i dhimbshëm. Me t'vërtetë shumë se qysh '76, '77, '78 qaty patën ardhë me më marrë për asistent nuk shkova. Se e kisha babën gjallë edhe e kisha të smutë. Nuk dojsha me u largu. Tek '96-ta ishte shumë vonë. Po shkova edhe mirë kalova. Në fakultet kom kalu mirë. Me koleg kom kalu mirë, me koleg në gjimnaz. Atje në Turiçec kom kalu mirë...

Anita Susuri: E në gjimnaz në '96-ten e keni lanë punën a po ma vonë?

Xhafer Ismaili: Jo në '96-ten.

Anita Susuri: '96-ten.

Xhafer Ismaili: Jo, ma vonë. Domethanë prej '96-tes kom punu edhe aty edhe aty tani dikur mas dy-tri vjete e kom ndërpre.

Anita Susuri: Kohën e luftës, pak para luftës.

Xhafer Ismaili: Po, po.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Po m'intereson tashti në Prishtinë jeni vendosë qatëherë kur keni fillu punën ktu apo edhe ma herët keni qenë? Qysh ka qenë puna?

Xhafer Ismaili: Jo, në Prishtinë jom vendosë shumë vonë, mas luftës. Se kam udhëtu prej Skenderajit. Kam udhëtu. Nuk e di. Ndoshta isha... në Skenderaj sikur t'mos kishte ndodhë ni aksident, aksident po e quj atë. Unë kisha libra shumë dhe e kisha ni para dhomë shumë t'madhe në Skenderaj, e kisha ni para dhomë plot libra. Ni moment ni e pandërgjegjshme që banonte ma nalt se unë atje e mbyll mbeturina të ndryshme, besa edhe pampersa në ata gypat e ujëmbledhësit dhe kthehet ujtë shkallëve nëpër mure edhe m'hyn n'libra.

Aty zhdërgjem poshtë me ni kafe, Dibra quhet ajo kafja. Shumë nervoz. Njëni thotë, "A po ma shet profesor banesën?" "Po". "Sa?" "Sa t'dush". Se e kisha atë nervozën. Nime sa t'dush ia shita. "Hajt hajt tregom ni çmim", ia dhash ni çmim. Qaty ia kom bo përhajër. Kur i pava librat e mia në atë gjendje kesh ka çmendna edhe kom ardhë tani në Prishtinë. A vllaun e kom pasë. Vllau ka qenë ktu në Prishtinë që ma shumë se 50 vjet i kish.

Anita Susuri: M'thatë që në '90-ten keni doktoru në psikologji a...

Xhafer Ismaili: Jo në të '90-ten, vonë kom doktoru. Unë '81 '82 jam përzan prej fakultetit të Sarajevës, kur kisha psikologji.

Anita Susuri: Në Sarajevë?

Xhafer Ismaili: Në Sarajevë unë e kam kry shkallën e tretë, ligjerata e kto. Po profesorët kanë qenë të Zagrebit e kanë qenë të Novi Sad e kanë qenë prej Beogradit e kanë qenë prej Prishtinës. Profesor Njazi Zylfiu prej Prishtinës atje vijke në mësim. Kur osht' bo ajo që ndodhi me Tahir Mehën neve na përzanën prej Sarajeve, profesorët e mi kur panë ashtu.

Ishte edhe Dem Hoti ka qenë aty, ka qenë Januz Dervodeli, ka qenë Aferdita Mulla. Ata të dy Januzin edhe Demën i morën profesorët i çun i regjistrun në Maqedoni, në Shkup. Na mbetëm në Sarajevë. Unë me nifar' të ndjeri ni Riza Kotorri. Kur shkum me u konsultue ata n'vend që me u konsultu me neve hynën n'bisedë të Tahir Mehës. Po thojnë, "Tahir Meha i ka vra katër djem t'ri, katër polic t'ri". Serbisht ata po flasin. Tash ai Rizahi u çu n'kamë tha, "Nuk kemi ardhë na ktu me u marrë me politikë, kemi ardhë me studiu, jemi ardhë me i përcaktu temat e magjistraturës". Se magjistrojshim tani doktorojshim.

Ai tani kërkoj falje tha, "Unë nuk jam", nifar' Herceg, Vladimir Herceg, tha, "unë nuk jom serb", tha, "jom hercegovan". Tybe s'di as sot çka osht' hercegovani a çka osht' serbi a çka osht' dallimi aty. Tha, "Hajdeni naj ditë tjetër". I mora në telefon. Merre me mend thanë, bash qiky Vladimir Herceg, "Nuk jom une". Ai ishte kryesus aty si dekan i fakultetit. E thirra edhe ni profesor tjetër ni Ismet Dizdarevic u kanë psikolog edhe ai nuk, nuk bon. E thirra njo në Zagreb, ni profesor të Zagrebit. Ai u përgjigj po ai tha, "Unë nuk jom, unë veç kom dhanë ligjerata aty se nuk kam lidhje administrative".

Ndëgjun tani profesori Pajazit që m'kishte dhanë mësim në studime themelore ktu. Profesori Neki, profesori Islam e profesor Hajrullahu. Dëgjun edhe thanë, "Eja ktu". Tani ktu edhe kom magjistru edhe kom doktoru në Prishtinë.

Anita Susuri: E në Skenderaj a keni qenë në kohën kur kanë ndodhë te Jasharajt?

Xhafer Ismaili: Po. Kemi qenë në të dy rastet në Skenderaj kur ka ndodhë kjo. Edhe rastin e parë kur e kanë rrethu edhe kur kemi shku tani me vizitu. Unë e kom pasë banesën përballë Jasharajt. Ajo fabrika e municionit dukej prej banesës time. E në këtë rastin e, në këtë rastin kur ndodhi kjo na kemi qenë në banesë. Po interesant kishim dëshirë, e nijsim vetën ma mirë kur bashkoheshim. Shumë familje prej katit t'naltë vishin te unë në katin e tretë rrishim bashkë. Ka qenë ai doktori Ali Thaçi, ni familje shumë shumë e mirë. Ka qenë ni gruja e tij ni Zyla ni burrnore shumë. Aliu ka vdekë, Zyla osht' gjallë. Ka qenë... vishin ata aty edhe na i ngushtojshim ata edhe ata neve. Frikësoheshin ma shumë në katin e naltë se ata gjujshin, gjujshin.

Kur osht' bo kjo ka ardhë ni grue e fqinjëve të Jasharajve me do fmi të Jasharajve që i kish shpëtu ajo. I kish marrë me veti. I bruni në banesë te Gani Deliu. Familjen e ksaj deputetës, Deliu. Ka qenë moment shumë i ranë ajo. Ata fmi ishin trem, ishin stresu. I pruni ajo plaka që i kish shpëtue. Nuk ka qenë e familjes të tyne ka qenë ma poshtë e ka pasë shtëpinë. I kish shpëtu i pruni aty në Skenderaj. Ka qenë rast... ne ende nuk besojshim, nuk besojshim se i kanë vra po thojshim e ka reklamë Serbia që po thotë i kom vra terroristat. Ende nuk besojsha që e kanë vra Ademin, nuk besojshim. Po ajo kishte qenë qashtu valla.

Ata burra, ata trima kanë vdekë t'u këndu. Hamza ka qenë edhe intelektual i madh. Hamza u marrë me art, u marrë me muzikë, u marrë me përgaditje të skenave të ndryshme artistike. Ka qenë i

gjithëanshëm. Ademi ka qenë temperament, temperament, shumë temperament po trim shumë i madh...

Anita Susuri: A keni shku pastaj në varrim e para varrimit...

Xhafer Ismaili: Po, po. Po ka qenë interesant se kur i kanë dërgue kufomat në... i kanë thanë aty ni, ka qenë një i materialit ndërtimor, nifar' Lah Tushilës, i kanë çu kufomat aty. Ende nuk e kishin, nuk e kishin qit' mjetet e informimit. Ende nuk i kish pa televizori ato kufoma mjerim. Unë nuk e kam ditë që djali im është t'u përkthi në fronte për ni amerikane edhe ni gjermank. Ato edhe e morën në fund djalin në Amerikë. Tash e kom djalin në Amerikë. Ai iu paska thanë atyne, "Në qoftëse nuk inxhizoni qito, nuk i paraqitni qito unë ma nuk përkthej për juve". Kurrë nuk m'ka thanë djali. Nifar' Abazi, Abaz Tërrnova m'ka tregu.

Tha, "Keshqim na", tha, "more djalë çfarë interneti ktu s'ka internet as kurgjo çka je tu thanë? Mirëpo", tha, "ajo gazetarja", tha, "e çoj kepekun e kerrit", tha, "preki diçka aty edhe na tha, 'Prej këtij momenti krejt bota është t'u i pa këto kufoma'". Po tani djalit i kanë thanë, "Ik se nëqoftëse vijnë paramilitarët ty të grijnë". Ni serb i ka thanë, "Ik". "A je ti djali i profesorit Xhafer?" "Po", "Ik se qitash me ardhë ata t'grijnë". Kur iu ka tregu atyne gazetarëve që qishtu po m'thotë tani ato gazetaret e kanë marrë. Kso momente ka pasë edhe momente ma t'rana.

Ni moment tjetër që u kanë shumë i ranë edhe i dhimbshëm ka qenë kur kemi qenë në Turiçec kemi mbajtë mësim. E përmenda këtë Qezibalën, këtë mësuesën e Bujanocit. Bashkë me to kemi qenë. Qat' ditë edhe e kanë vra atë vozitësin që na kish çu, nipin e Avdisë, drejtorit të shkollës. Thotë... ka qenë e premtë. Thotë, "A po kthehum a po rrijmë?" Thashë, "Si t'dush", tha, "Po rrijmë se vjen baba i Ademit", burri saj Adem, vjehrrin. "Kom qef m'u taku me to". Fati që unë nuk kom nejt. S'di çka m'u tek du me shku për Prishtinë se i kisha fmitë në Tauk Bahçe.

Unë jam nisë me autobus. Kur jemi ardhë në Komoran, që i thojshin ai punkti ma fam keq që s'lejshin kërkond. Aty na kanë nalë po ni kondukter ju kish ble atyne militarëve sene. Pije, sene. Ua jep edhe na lirun. Na lirun aty po nuk shkoj gjat te Kroni i Mbretit i thojnë aty ka qenë ni fabrikë e pulave, dolën tjetër. Si hinën në autobus thanë, "Kush osht' ktu prej Skenderajit?" "Ko je tu iz Srbice?". Qysh m'i ngulën sytë mue. M'kqyrshin (qeshë). Unë për fat ni gru u frikësu shumë, ishte shtatzanë. Thashë, sa t'bohet ktu far' maskarallaki, frike po lajmërohna unë edhe paq.

Unë t'u u çu kanë mrrri dy kerre të UNMIK. Nja u nalë para autobusit njo mas autobusit. Ata qat' natë ishin kanë t'u u tërhjekë UNMIK-u. Kanë dalë ata policia, kanë dalë meniherë jashtë. Ka qenë shpëtim për mua qata. Kur erdha ktu e takova burrin e Qezibalës tha, "Çka po bohet atje?" Thashë qishtu qishtu. Thashë, "Qezi mbetë atje?" Qez i thojke asaj. Thashë, "Po valla, mbet". Kanë mbetë të ndam gjatë ton luftës ata dy kanë mbetë të ndam. Gjatë luftës kurrë s'kanë mujtë m'u bashku deri mas luftës. Kto momente shumë t'ralla.

Anita Susuri: E mësimi ka vazhdu po m'duket deri vitin e bombardimeve a po? A po ma herët?

Xhafer Ismaili: Mësimi nuk osht' nalë deri ditën kur NATO-ja ka fillu me bombardu, nuk osht' nalë. Qashtu n'qato kushte kemi vazhdu, kemi punue.

Anita Susuri: A u bo edhe ma e vështirë pastaj?

Xhafer Ismaili: Po sigurisht u bo ma e vështirë. Kta u egërsun shumë, kta u bon, u bon shumë të ashpërt tani u bon. Kishte ktu gjithfar' policësh që përdorshin edhe drogën u dashke m'u rujtë prej tyne shumë. Kjo ishte... sidomos, jo pse unë jom i Drenicës po ai akcenti kryesor i tyne ka qenë Drenica. Ka qenë... edhe mandej u përhap gjithkund. U bo krejt Kosova Drenicë. E thojshin nëpër protesta, "Drenicë jemi me juve". Nime u bonën me to edhe faleminderit se cep më cep Kosova u bo Drenicë. Të gjithë i morën pushkët, të gjithë dolën.

Anita Susuri: M'tregut që keni qenë në Prishtinë gjatë gjithë kohës derisa ju ka largu prej banesës ushtria apo? Serbe?

Xhafer Ismaili: Po.

Anita Susuri: Jugosllave.

Xhafer Ismaili: Ktu ku rrishim te Pajaziti që kishte edhe shumë familje të tjera të Drenicës aty. Pajaziti i ndjeri dilte edhe bante fjalë me fqinjët e vet që kishin shpija tri katër katëshe e nuk e pranonin kërkond prej familjeve. Ky zihej me ta, "Pse bre s'po i merrni?" Ky nishin atje të kuzhinës e pat' shtru me sungjera me ju ba vend jo vetëm vend me flejt po edhe ushqimet ua sillke, edhe barna ua sillke. Unë familje që ka kontribu ma shumë se familja e Azem Lajçit, Pajazit Lajçi nuk njoh gjatë luftës. Aty mandej e vajtën ni paramilitar te Tauk Bahça edhe u acarua puna shumë.

Unë ika. Djalë edhe vajzën... ika te djali i axhës kha ku ish t'u banu ma në qendër se thojshin në qendër ma qetë e anej në Tauk Bahçe u bo mos vet. I pruna fminë e mi kha po mas dy nete masi i pruna erdhën katër-pesë djem aty edhe ju shtrun në koridor me flejt. Thashë, "Jo në koridor s'keni me flejt keni me flejt në dhomë me mu edhe me shoqen teme. Juve ju kem fmi si tont jeni", tha, "Profesor na ty po t'njohim", njani, tha, "a je profesor Xhaferi?" Tha, "Na e kemi kry shkollën e mesme në Skenderaj tani jemi ardhë n'fakultet", tha, "kemi banu te", filani s'po përmendi emër. Tha, "Na përzuni tha, 'S'guxoj me ju majtë se jeni të Drenicës, ikni'".

Thashë, "Ju sonte nuk keni me flejt në koridor po keni me flejt bashkë me neve". Shoqja m'tha tha, "Ti", tha, "fmitë tu i ke ikë prej ktuhit", tha, "po don m'i nalë ktu kta". Në atë moment ka kërsit dera, kanë ardhë paramilitarët. Atyne ju kom thanë, "Dilni ju prej dritareve e hini atje në Tauk Bahçe ikni

n'atë anë deri t'merrna vesh unë me ta". Qaty ma kanë pre xhamperin. Se lypshin pare. "Ku i keni paret që po i tuboni për UÇK me na vra fminë tanë?" Edhe e preu.

Qaty shoqja ka dalë me nifar' çante n'dorë. Na kanë qit' qashtu. Shoqes ia kanë marrë 5 dinar, n'grusht i kish pasë. Thotë, "Shqip m'kanë thanë, 'Paret që mi ke dhanë'" Po, për zot. Mu ma kanë dathë kpucen. Qysh e kanë ditë ata e dijnë m'i kanë marrë 800 marka, n'kpucë i kom pasë edhe m'qitshin me m'vra. "Qit pare tjera a po të vrasim?" Tri herë derisa qajo Serbezja, ni gru shumë gru e mirë, mas luftë ka vdekë prej kancerit ka vdekë. Ajo edhe në Bllacë atje m'i ka dhanë dhetë marka me shku me folë me telefon me fmitë, me ditë çka u bo.

Anita Susuri: E ju asni fmi ktu s'e keni pasë?

Xhafer Ismaili: Mu më mbetën dy fmija ktu, vjaza edhe djali më mbetën ktu edhe te ai djali i axhës që kanë nejt, ai djali i axhës veç ni djalë. Tash osht' rreziku, ka rreziku djali. Hajde me ia nxan djalin osht' djali yt po rrin ktu po kta? Pse kanë ardhë kta ktu? U çu djali me ni djalë të Vehbisë me shku tjetër vend. Ia kanë vra ni djalë t'ri para kamve ia kanë vra. I ka marrë ni grue e ni mikut tem, gruja e ni doktorit Nexhmedin Hotit. I ka marrë i ka strehu pak aty n'shpi t'vet mandej i ka kthy prap te Rifati. Mas dy dite i kanë marrë edhe ata i kanë pru në Bllacë, jemi zatet me ta tani. E vajza e madhe osht' në arsim punon. Ajo gjatë luftës ka qenë në mbrojtë aty në Turiçec vazhdimisht me fmi.

S'di na vishin lajme që e kanë vra, jo s'e kanë vra. Po s'e kishin vra. Shpinë aty na kishin djegë. Aty ka nejt edhe UÇK-ja n'shpi teme. Ata e kanë djegë e kanë bo rrafsh. E qishtu kjo...

Anita Susuri: E prej Bllacës a keni qëndru? A jeni kthy pastaj? A keni udhëtu?

Xhafer Ismaili: Jo, në Bllacë kemi nejt aty. I kom pa njerëzit tu e bo varrin vet. Se "Si t'des ma gjuni do dhe përmi", "Jo more hajt se s'dek". Kom pa njerëz që janë çmend. Ka ardhë njo i jemi për burrë t'vetin m'ka thanë, "T'lutem profesor jepja ni kokërr qetësuese se ai s'ka qenë mirë edhe përpara tani edhe lufta". Mu ka deshtë me pi kokërr qetësuese veç me shti edhe ata me pi. "Qe edhe une pe pi bre". Ai mandej folke gjithçka. Aty tani kemi flejtë... kemi flejtë me thanë se çfarë flejti ka qenë ftoft. Ka qenë prilli po ka qenë shumë ftoft, borë rake.

Une masi s'na lashin me dalë se dalshim deri ngat me kalu kufinin na kthejshin bovaki qata t'partë i kthejshin t'partë metshin tani. Aty na kanë pritë mirë. Kanë pru ushqime. Kanë pru bukë, kanë pru... natën e parë kanë pru bukë t'gatune kshtu pogaçe se jo t'furrës. Kanë pru konzerva, kanë pru djath, gjithçka. Shumë shumë janë kanë t'kujdesshëm. Mos t'flasim për qebe për kto. Mirëpo na si na. A besoni që kur kemi dalë s'mujshim me ecë prej qebeve e prej pampersave e prej bukës. T'u rezervu bukë pa pasë nevojë. T'u u tutë që vdesim uni rezervu bukë, palo bukë kah 20 bukë.

Unë jam shti sikur jam smutë se ndrysh s'na lejshin me dalë. E kom pasë ni ves n'zemër, jo ves, qashtu e kom pasë që me u përbi m'rrehke zemra ma shpejt. Thom, "Jom smutë". Ata tani për me t'kontrollu që je smutë t'kontrollojshin edhe niherë. Kur m'kanë kontrollue ma kanë pa qat' aritmi. Kjo vajza e vogël, "O vdiq baba". U hi nëpër pëndreka të atyne u ardhë te une. Unë ia shtrëngojsa dorën i thojsha, "Buje mos u tut se s'jam smutë". Kush mujke m'i nalë. Tani qashtu edhe shoqja u dalë diqysh se burri po don me m'dekë edhe ky djali vogël qashtu e na kanë çu në Tetovë.

Në Tetovë kemi nejt. Ishin kanë do t'mirë ishin kanë po fukare ishin kanë. Kshtuqë e kisha djalin në Gjermani, t'madhin. Na çoj pare. E bona ni dhomë të tina e rregullova ia ngjita dritaren e derën e dyshe-menë, rrishim qaty. Ato ndihma çka na dhashin ia lasha atij s'merrsha për veti kurgjo se kishin qenë t'varfër kishin qenë. Djali tani qashtu u lidh me ato gazetaret edhe mu m'tha, "Nuk shkoj në Amerikë. Po m'vjen keq prej tyne po shkoj deri në aeroport e n'aeroport kishe po i bi pishmon". Nuk i ra pishmon po kur na thirri na thirri prej Washington.

"Ku je Ariton?" Tha, "Në Washington". U mërzitëm shumë. U mërzitëm shumë se kur shkum aty ku kish nejt në Çegran në atë shatorin e vet ku kish nejt i kish shkrujtë vargjet e Latif Berishës 'Tri gotat'. Ato janë vargje shumë të dhimbshme. Qashtu thotë 'Në livadhin e gjatë të jetës tri gota i gjeta dy ishin të mbushura e shprazt ish e treta. E mora të parën e kërkova po m'dogj meniherë e largova. E mora të dytën te buztë e ofrova më dogj shumë prej së ombli dhe e largova. E mora të parën dhe të dytën i shpraza në të tretën gotë u bo e idhët qysh është vet kjo botë'. Këto vargje i kish shkrujtë në shator dhe na mërzitën shumë na mërzitën. Edhe ish ikë tani.

Anita Susuri: Pastaj kur ka përfundu lufta sigurisht përmes mediave keni kuptu apo radios a televizionit?

Xhafer Ismaili: E kuptum përmes televizorit edhe përmes radios. Po mjetet e informimit në Maqedoni funksionojshin gati për gjithçka u informojshim. E kuptum që ata po tërhiqen po na thojshin, "Mos u gutni meniherë me shku se nuk osht' mirë me shku meniherë". Po secili neve na u ngutke. "Janë rrugët e minune", thojshin. Bile anej kah kom ardhë unë me vajzën dhe shoqen plot ka pasë gropa nëpër asfaltt që kish pasë mina i kishin çmontue. Plot ka pasë gropa. Deri në Ferizaj ka pasë plot aso gropa.

Erdhëm, erdhëm ktu. Banesën interesant kish nejt ni gru e Llaushës aty. E pytshim, "Pse nuk i kanë prek këtu libra?"...

Anita Susuri: Serbe a?

Xhafer Ismaili: Jo, jo. Interesant. Thojshin, "Jo nuk t'i kanë prek librat". Veç fotografinë që e kom pasë të Skënderbeut aty tha, "E hiqshin". Me thy nuk e kishin thy, "Veç e lshojshin poshtë", tha, "e kthejshin me ftyrë për muri", po për zotin. "Televizorin", tha, "ta kanë marrë". Po televizorin e kishin marrë. Po kjo grua e kish bo llo-m atë banesë, moza ma keq e kish ba. U desht me ia nisë prej zeros tani.

Anita Susuri: Pastaj edhe sigurisht keni punu edhe pak edhe tani keni dalë në pension a po? Kur keni dalë?

Xhafer Ismaili: Jo tani kom punu une deri me, kom dalë në 2017-ten në pension. Se na n'fakultet kemi pasë t'drejtë me punu deri në 70 vjet.

Anita Susuri: Po, po, po. E si ka qenë qajo rimëkëmbje? M'u kthy prap? M'u organizu prap? Tjetër shtet, tjetër...

Xhafer Ismaili: Po na majke ajo... ai gëzimi. Na majke ai gëzimi që u çlirim. Kshtuqë ajo na amortizojke ajo anën materiale që s'e kishim që na mungojke. Solidariteti ishte në kulm meniherë mas luftës. Ma vonë u çoroditëm. Se ndihmojshim njani tjetrin, ndihmojshim atë që s'kishte, ndihmojshim atë që s'kishte ku me u vendosë, e strehojshim. Qe djali i vllaut tim deri e ka bo shpinë ka nejt në banesën time. Deri e ka bo shpinë. E shumë tjerë ju bojshin halle. Po ma vonë, ma vonë nuk vazhdoj kjo. Për çudi nuk vazhdoj kjo. Filloj nifar' egoizmi, nifar' apetiti me pasë, m'u bo ma i pasur nuk e di pse. Nuk e di pse. Ishin njerëzit e traumatizun, ishin të stresun. Ajo ndikoj.

Kom shkrujtë unë dy libra për stresin mas luftës. Kom shkrujtë 'Stresi tek nxënësit e shkollës fillore' edhe 'Stresi tek arsimtarët' se edhe arsimtarët ishin të stresun. Kshtuqë e pava unë se m'tregoj përvoja ime se sa stresohet edhe arsimtari përveç nxanësit. Sa e ndin atë çfarë empatie ka për nxanësin arsimtari. Kjo luftë na tregoj.

Anita Susuri: Zoti Xhafer nëse doni për fund diçka me shtu, nëse kemi harru diçka me përmend.

Xhafer Ismaili: Jo, kjo është histori e gjerë për secilin, çdo individ e ka atë historinë e vet. E di që kom lanë nashta shumë gjana shumë ma t'rëndësishme se kto që i thashë po megjithatë edhe kto mjaftojnë. Unë si, si apel kshtu si porosi e kam gjithmonë atë që t'jemi sa ma t'afërt me njani tjetrin. Jo të afërt vetëm fizikisht po me qëndrime, me motive, me emocione, me punë. T'jemi sepse emocionet janë ato që i lidhin skajet e botës. Kjo bota jonë materiale osht' shumë e vogël në krahasim me atë botën emocionale.

Unë e thashë ni ditë ni postim, m'doket ma panë t'madhe do thashë, 'Shumë intelektual nuk e kanë rrokë pushkën po i kanë mush ato, ma herët i kanë mush ato'. I kanë mush se kemi... mu m'u nisën shumë... unë nxanësit e mi i marrshin atëherë i çojshin i pytshin, "Çka ka shpjegu profesori?" Në shkollë fillore kur dhasha mësim. Nxaësit qaq t'mirë sa thojshin, "Ka shpjegu qata që po e shihni në ditar". Unë shkrujsha histori tjetër shpjegojsha diçka tjetër. Shpjegojsha për Skenderbeun sa mujsha.

Kshtuqë kam dëshirë m'u kthy ato kohë, me qenë ma t'dashur ma të afërt njani me tjetrin. Ma solidar me njani tjetrin. Nuk e di çka mundet rme ndodhë edhe diçka tjetër përveç asaj që ndodhi që ne m'u

mush mend. Porosia ishte intelektuale. Ju përmenda atje, a ka poezi ma të madhe mbushje ma e madhe se vargjet e Ali Podrimjes, 'Kosovë unë jam gjaku yt që nuk falet?' Kjo i nxiti edhe t'ritë m'i marrë pushkët edhe me dalë se me t'vërtetë gjaku i Kosovës nuk falet.

Anita Susuri: Faleminderit shumë!

Xhafer Ismaili: Me nder qofshi. Faleminderit juve!